

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

DITA E VERËS NË STRUGË

(tribunë shkencore – 14.03.2016)

- 15 -



Shkup, 2016

Boton:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE –
SHKUP

Vëllimi 15 – 2016

Biblioteka: **SCUPI**

Për botuesin:
Prof. dr. Skender Asani

Kryeredaktor:
Prof. dr. Sefër Tahiri

Këshilli redaktues:
Prof. dr. Skender Asani
Prof. dr. Bukurije Mustafa
Prof. dr. Izaim Murtezani
Prof. dr. Sevdail Demiri
Mr. Rini Useini

Sekretar i redaksisë:
Mr. Rini Useini

Redaktor teknik:
Naser Fera

Copyright© ITSHKSH, 2016
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin.

ISBN 978–608–4653–43–1

www.itsh.edu.mk

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

DITA E VERËS NË STRUGË

(tribunë shkencore – 14.03.2016)

- 15 -

SCUPI

Shkup, 2016

TRYEZA E LËNDËS:

HYRJE.....	7
DR. IZAIM MURTEZANI: SIMBOLIKA E <i>VERORES</i> NË KREMTEN PAGANE TË DITËS SË VERËS TE SHQIPTARËT E MAQEDONISË	11
BUKURIJE MUSTAFA: DITA E VERËS RELIKT KULTUROR NË FSHATIN PATISHKË–KARSHIAKË	34
VEBI BEXHETI: DITA E VERËS, FESTË MBARËSHQIPTARE ME ORIGJINË PAGANE.....	41
PROF. DR. HAMIT XHAFERI: SIMBOLIKA E DITËS SË VERËS NË TREVËN E KËRÇOVËS	50
PROF.DR. MUSTAFA IBRAHIMI: DITA E VERËS NË TREVËN E PELAGONISË.....	58
NESHAT MEHMEDI: DITA E VERËS	69
RINI USEINI: DITA E VERËS NË STRUGË DHE SIMBOLIKA E SAJ.....	85

HYRJE

Popujt në zhvillimin e tyre evolutiv i kanë zhvilluar edhe teknikat e njohjes së kohës dhe hapësirës përreth vetes. Koha është një nocion i rëndësishëm në jetën e njeriut, prandaj, njeriu të themi arkaik në bazë të përvojës së tij, e ka shikuar se dielli luan një rol të rëndësishëm në jetën e tij. Prandaj në mënyrë shumë të bukur në bazë të lëvizjes së diellit ka bërë ndarjen e kohës në mënyrë të mahnitshme. Ai e ka ndarë vitin në dy mote, dhe atë vera e cila fillon prej Shën Gjergjit e deri në Shën Mitër, e dimri që nis nga Shën Mitri e vazhdon deri në Shën Gjergj. Ndërmjet këtyre dy pikave kohore, në bazë edhe të zhvillimit brenda tokësor, ai ka shikuar kohën e zhvillimit të vegjetacionit, atëherë kur toka është pjellore, dhe ka dalë pak nga thatësia dimërore. Dhe pikërisht kjo është më 14 mars, apo siç ndryshe quhet Dita e Verës. Kjo ditë për shkak të rëndësisë dhe kërkit në mënyrë sakrifikuese dhe gazmore të të mirave materiale nga natyra ka marrë tiparet e një feste e përmbushur përplot me rituale të ndryshme, të cilat kanë në fakt shkak—pasojën e njëjtë në çdo hapësirë konkrete, por që mund të manifestohen në mënyra të ndryshme.

Është një festë me prapavijë shumë të vjetër, pasi në vetvete është pjesë e ciklit të kalendarit popullor, që do të thotë e të gjithë popujve që rrënjët e tyre i kanë në antikitet. Mirëpo mënyra e jetesës ka arritur deri në atë fazë që këtë festë ta ruajnë vetëm popujt ngultësor apo autentik të cilët edhe nuk kanë qenë të ndikuar nga mënyra industriale e të jetuarit. Është ruajtur me fanatizëm dhe përdorur deri në fund të viteve 90—ta në mënyrë masive, pasi sipas informatorëve në terren ajo nuk ka qenë një festë argëtuese por e domosdoshme, me qëllim që t'i bëhet nder tokës e cila ia jep njeriut ushqimin e jetës. Ndër shqiptarët e Maqedonisë sipas tematikave të cilat janë në këtë përmbledhje mund të konstatojmë se Dita e Verës festohet në shumë hapësira, mirëpo

me zbehje më të theksuar për shkak të ndikimit të globalizimit dhe teknologjisë së re moderne, e cila del me zhvillimet më të fundit njeriun e varur prej natyrës e kanë transformuar në njeri të varur nga teknologjia. Por shumë praktike, rituale dhe monumentale kjo festë ende është e pranishme në fshatrat e Strugës, ku për çudi edhe pse vend turistik, i urbanizuar dhe deri diku i modernizuar ende praktikohen ritet e Ditës së Verës të cilat tashmë kanë kaluar nga praktika rituale ceremoniale në praktika festive gazmore. Por është me rëndësi që ende janë shumë atraktive për vendasit, të cilët mund të vijnë edhe nga shtetet e jashtme posaçërisht për këtë festë, sepse e duan traditën, e ritet e saj, të cilët atë nuk e ndajnë nga vendlindja, sikurse dhe pasardhësit e tij.

Ritet janë trashëguar brez pas brezi ndoshta për 24 shekuj me radhe. Dikur dedikimet i kushtohen perëndisë Diane, sot ato praktikohen për një jetë me te mire te mbushur me gëzim, dashuri dhe begati. Studiuesi dhe muzikologu i njohur Thanas Meksi e ndan në katër faza Festën e Ditës së Verës. Faza e parë është faza përgatitore që nis me grumbullimin e zaireteve që janë të nevojshme për Ditën e Verës. Faza e dytë është Nata e Verës që nis me 13 mars me zjarrin, faza e tretë Mëngjesi i Ditës së Verës që nis më 14 mars dhe së fundi pikniku i Ditës së Verës në mesditën e 14 marsit.

Ajo që asocon si e përbashkët duke u lidhur me mënyrën e praktikimit në rrethinën e Strugës është kulti i vegjetacionit. Në çdo krahinë etnografike përdoret një lloj bime apo degë peme me të cilën stoliset shtëpia, me të cilën asocohet në një vit më të begatshëm dhe shëndet më të mirë për anëtarët. Në Strugë si bimë karakteristike është një lloj barishte që lulëzon në ditët e para të marsit e që quhet kukurek. Një ditë para mblidhen barishtet, që të jenë të gatshme të rregullohen në Ditën e Verës. Kurse pikërisht në Ditën e Verës karakteristike është përdorimi i vezëve rituale, të cilat zakonisht janë të kuqe, ngjyrë të cilën e marrin nga lëvoret e qepëve të cilat i hedhin në ujë kur i ziejnë vezët. Veza përdoret dhe

në ditën e parë, e marrin fëmijët me vete dhe në ditën e dytë kur shkojnë shtëpi më shtëpi për të mbledhur vezë dhe ditën e tretë kur shkojnë për vizita te të afërmit dhe dërgojnë disa kokrra vezë, zakonisht për fëmijët. Veza është me rëndësi të madhe në teorinë etnologjike sepse përfaqëson kozmosin, zhvillimin e jetës, begatinë dhe riciklimin jetësor. Prandaj dhe jo më kot është një objekt me rëndësi të madhe rituale edhe nëpër festa të tjera popullore apo fetare, njëkohësisht edhe si dhuratë për fëmijët e vegjël kur shkojnë për vizitë diku.

Vitet e fundit "Dita e Verës" është bërë me të vërtetë një festë mbarëkombëtare me tendenca moderne argëtuese, ku festohet masivisht nga të gjithë shqiptarët pa dallim moshe, besimi fetar dhe krahinor. Kjo tregon se shqiptarët edhe në festa janë të bashkuar, si një trung i vetëm duke treguar se janë një komb i vetëm dhe që kanë vetëm një identitet, atë shqiptar, i cili rrjedh nga qytetërimi antik Ilir, ndër më të vjetrit jo vetëm në Ballkan por edhe në Evropë. Dita e Verës e vërteton këtë lidhje, sepse vetë Dita e Verës është shumë e lashtë për nga koha e krenimit dhe mënyra. Është festë pagane që rrjedh nga lashtësia dhe që është ruajtur me shumë fanatizëm deri në ditët tona. Natyrisht që nga fillimet e krenimit të saj deri sot, kohët kanë ndryshuar dhe për rrjedhojë edhe mënyra e festimit, por forma e saj bazë është po e njëjta, ka qenë dhe mbetet një festë pagane, me origjinë dhe traditë shqiptare dhe që i dedikohet stinës së pranverës, me të cilën rigjallërohet gjithçka pas një gjumi të lodhur dhe të gjatë dimëror.

Nga pjesëmarrësit në këtë konferencë kjo festë u përshkrua me një entuziazëm dhe u parashtrua e njëjta kërkesë që kjo festë të shënohet në rangun e festave me rëndësi të veçantë dhe të ruhet në UNESCO si trashëgimi kulturore me mënyrën e krenimit të veçantë shqiptar. Njëkohësisht u kërkua që të ketë edhe konferenca të tjera shkencore që të përshihet një brumë më i madh material për tu studiuar kjo festë më hollësisht dhe njëkohësisht të shënohet në mënyrë institucionale si festë publike. Kjo konferencë shkencore u

mbajt në qytetin ku dhe momentalisht festohet Dita e Verës–Strugë, në organizim nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, në bashkëpunim me Shoqatën për Art dhe Kulturë “Liqeri”. Me tema në këtë konferencë shkencore u prezantuan përfaqësues nga Instituti si organizator, nga Instituti i Folklorit –Shkup, nga Universiteti Shtetëror i Tetovës, Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë etj.

Redaksia e revistës "Scupi"

DR. IZAIM MURTEZANI

Instituti i Folklorit në Shkup

SIMBOLIKA E VERORES NË KREMTEN PAGANE TË DITËS SË VERËS TE SHQIPTARËT E MAQEDONISË

1. Hyrje

Verorja paraqet padyshim një ndër elementet më përbashkuese, apo më unifikuese në kuadër të të gjitha ritualeve dhe praktikave magjike që ekzekutohen gjatë Ditës së Verës në të gjitha viset e banuara me shqiptarë në Republikën e Maqedonisë. Verorja si element i kremtimit pagan po ashtu haset edhe në pjesët tjera shqiptare. Kështu, në vise të ndryshme të Kosovës edhe më tej “ruhet tradita e lidhjes së “laramanëve” në dorë të fëmijëve (penj dyngjyrësh: kuq e bardhë) (Xhemaj, 2005: 119), kurse të njëjtën praktikë magjike e hasim edhe në vise të ndryshme të Shqipërisë, madje ndonjëherë edhe me emërtime të ndryshme. Në Tiranë, sipas të dhënave që jep studiuesi Azem Qazimi, verorja quhej *lars* – i, kurse në vise të ndryshme njihej edhe si *guduverë*, *vërojke*, *manak/e*, *peri i Marsit*, *apo Marsi* e kështu me radhë (Qazimi, 2008: 137). Edhe te shqiptarët e Maqedonisë, verorja njihet me emërtime të ndryshme si *martinkë* (nga emri i muajit Mars) në fshatrat toske të Strugës, *silnikeshë* në disa fshatra të Gostivarit, *skilimiresh* në disa fshatra të Dervenit të Shkupit, *linik* në Kalishtë të Gostivarit, *verojkë* në fshatrat e Prespës, *peçat* në fshatin Patishkë të Shkupit e kështu me radhë. Pra, kemi të bëjmë me variacione të ndryshme emërtimesh, por njëherit edhe me një përhapje tejet të gjerë, apo mbarëkombëtare të kësaj praktike magjike, por edhe më shumë se kaq, pasi verorja, nënkuptohet me emërtime të ndryshme, apo të ngjashme, është e pranishme edhe te popujt tjerë, sidomos të

arealit ballkanik, si te maqedonasit, bullgarët, grekët, rumunët, etj. E gjithë kjo përhapje kaq e gjerë e verores te popujt e Ballkanit me siguri se të bën të mendosh se kemi të bëjmë me një praktikë magjike që vjen nga koha e popujve të lashtë të Ballkanit me ç'rast mes tjerash do të kishte qenë i pashmangshëm edhe ndikimi i fiseve të ndryshme ilire që në të kaluarën kanë përfshirë një territor të gjerë banimi në kuadër të trevave ballkanike.

Në përgjithësi, pothuajse në të gjitha viset shqiptare, verorja nënkuptonte një gjalmë të dredhur me pe të kuq dhe të bardhë që u vendosej rishtarëve në pjesë të ndryshme të trupit, nënkuptohet me pretendime të ndryshme, kryesisht të karakterit magjik. Ajo mbahej për një kohë të caktuar dhe pastaj vendosej, në shumicën e rasteve, në ndonjë degë peme, ose diku tjetër.



Fig. 1

Verore e varur në degë të një peme

Duhet theksuar se verorja, por edhe shumë rite dhe praktika tjera magjike, si dhe besime të ndryshme që ndërlidhen me festën kalendarike të Ditës së Verës kanë mbijetuar kryekëput me përmbajtjen e tyre pagane duke mos pësuar ndonjë modifikim që do të ndërlidhej me fetë monoteiste, veçmas me atë krishtere, ashtu siç ndodh me disa festa tjera kalendarike. Kjo festë, me të drejtë

konstaton studiuesi ynë i njohur, Qemal Haxhihasani, mbeti “një nga festat tona popullore tradicionale ku shprehen më me origjinalitet lidhjet e thella shpirtërore të shqiptarit me përtëritjen e natyrës, përtëritjen e jetës, botën e luleve, të punës, të pjellorisë” (Haxhihasani, 1988: 59).

Në kontekst të veroreve duhet theksuar se përpunimi i tyre bëhej nga gratë më të moshuara, ose edhe më të reja që do të thotë se kemi të bëjmë me një aktivitet magjik kryesisht të gjinisë femërore. Megjithatë, bartja e veroreve përpos gjinisë femërore, ndonjëherë bëhej edhe nga gjinia mashkullore. Nënkuptohej se pothuajse të gjitha aktivitetet magjike në shoqëritë tradicionale janë të rezervuara për botën femërore, pasi ajo i din “fshehtësitë” e lindjes, përkatësisht pjellorisë, por njëkohësisht ajo i din edhe kundërpraktikat tjera magjike që ndërlidhen veçmas me mbrojtjen e shëndetit dhe pjellorisë.

Dihet se ushtrimi i aktivitetit magjik që ka të bëjë me veroret ndërlidhet me Ditën e Verës që kremtohet kryesisht më 14 Mars. Kjo kremte pagane është një festë tejet e dashur dhe domethënëse pasi nëpërmjet saj njeriu me bindje pagane është futur në një kohë të re në të cilën priste që natyra t’ia siguronte produktet e nevojshme ushqimore në funksion të mbijetesës së tij. Jorastësisht edhe në Romën e Lashtë, fillimi i Vitit të Ri ndërlidhej me 1 Marsin e jo me 1 Janarin, ashtu siç është sot. Pra, rezulton se Dita e Verës me siguri se do të ketë shënuar fillimin e një viti të ri kalendarik, pasi njeriu me bindje pagane, në të kaluarën e largët, ka njohur vetëm dy pjesë të vitit, përkatësisht verën dhe dimrin.

Me këtë rast bëhet tejet e qartë pse njerëzit kanë tentuar që nëpërmjet përpunimit të verores, si një lloj i veçantë i hajmalisë, të ndikojnë pozitivisht ndaj shëndetit të tyre gjatë vitit në vazhdim, kurse në disa raste edhe ndaj bagëtisë dhe me këtë edhe në ndjelljen e përgjithshme të mirëqenies ekonomike. Sipas historianit tanimë të njohur të religjioneve, Mirça Elijade, koha e ndërrimit të cikleve

kalendarike, përkatësisht shkuarja dhe ardhja e një cikli kalendarik paraqet periudhë ideale për zhvillimin e veprimeve rituale dhe magjike me të cilat tentohet të ndikohet kundruall nevojave qenësore ekzistenciale të njerëzve, siç janë shëndeti, fati, pjelloria, mirëqenia ekonomike, etj. (Eliade, 1969: 57). Nëse edhe festa e Ditës së Verës venerohet si fillim i një viti të ri kalendarik, atëherë është krejtësisht e qartë edhe ndërlidhja e praktikës magjike së veroreve me këtë kohë, përkatësisht me fillimin e një periudhe të re kohore në aspektin kalendarik.

2. Aktivitetet magjike që ndërlidhen me veroren

Aktivitetet magjike që i referohen verores janë të ndauarduarshme dhe posedojnë edhe disa cilësi specifike, varësisht se cilit rajon i përkasin. Megjithatë, peri i kuq dhe peri i bardhë me të cilin karakterizohen veroret, si dhe funksioni i njëjtë magjik i tyre është elementi që i përbashkon ato, madje të gjitha zonat, apo vendet ku praktikohet ky lloj i veprimit magjik. Variacionet e praktikimit të këtij akti magjik vijnë në shprehje vetëm në raport me mënyrën e përpunimit të veroreve, organin trupor të vendosjes së tyre, pastaj kohëzgjatjen e mbajtjes dhe mënyrën e braktisjes së tyre e kështu me radhë. Sa u përket këtyre variacioneve të praktikimit të veroreve mund të themi se në vija të përgjithshme ekzistojnë të dhëna etnologjike të njafueshme pothuajse për të gjitha viset ku jetojnë shqiptarët, veçmas në Maqedoni. Në këtë drejtim, të dhëna tejet të begatshme, sidomos për fshatrat e rajonit të Tetovës dhe Gostivarit ofron studiuesja e njohur Edibe Selimi Osmani në librin e saj me titull *Rite e besime popullore në viset e Tetovës dhe Gostivarit*. Ajo thekson se “në fshatrat Sërbinovë, Qafë, Tërmovë, Strajan dhe Padalishtë, verorja quhet silmikeshtë. Këtë e përgatit e zonja e shtëpisë e cila në penjtë e përdredhur (kuq e bardhë) var një pjesë të vogël të kungullit të egër dhe një thelb hudhre. Burrat e mbanin silmikeshtë në palën e brezit, kurse gratë dhe vajzat mbanin dy silmikeshta, një të lidhur për qafe dhe një për bylyzikun

e dorës së djathtë. Silmikeshat mbahen deri ditën e Shëngjergjit kur fshatarët i hedhin në ndonjë burim me magjinë verbale: *Silmikeshat teposhtë, shëndeti tërmo* (Selimi–Osmani, 1996: 53). Në fshatrat Debreshtë, Vrapçishtë, Toplicë dhe Negotinë të Gostivarit, thekson studiuesja e njëjtë, “e zonja e shtëpisë dridhte pranë vatrës dy penj, kuq e bardhë, duke pëshpëritur fjalët: *Ja msheli¹ dushmonit gojën, mës na boje munxhi*.² Peri u vihej fëmijëve deri në moshën 8 vjeç, lehonave dhe grave shtatzëna që lindnin për të parën herë (Selimi–Osmani, 1996: 55). Veroret, apo silmikeshat, siç i quajnë në këto fshatra mbahen tri ditë dhe pastaj hiqen nga duart dhe fëmijët e gratë (si bartës të tyre) i lidhin në degën e thanës. Verorja në fshatin Kalishtë të Gostivarit quhet *linik*. Ditën e Verës, në mëngjes, pasi i lajnë fëmijët *linikun* e varin te trëndafili i kuq duke thënë: *Me nijet t'allahit, t'ëm rrejtet Naini, t'bohët i fort si thona!* (Selimi–Osmani, 1966: 57). Edhe në fshatin Debërcë të Tetovës, “çdo amvise, secilit anëtarë të familjes i qep fshehurazi dy penj, bardh e kuq, nën krahun e djathtë të këmishës. Ritual i përcillet me fjalët: *Çepi gojën e xharpnit, t'bollës, çepi gojën e dushmonit, çepi barkdrasën, gojën e ujkut*. Peri i qepur mbahet tri ditë; ai hidhet në burimin e rrjedhshëm të fshatit” (Selimi–Osmani, 1966: 63). Pothuajse i njëjti aktivitet magjik zhvillohet edhe në fshatrat e Dervenit të Shkupit ku verorja quhet *skilimiresh*. Kështu, në fshatrat e zonës në fjalë, në mbrëmjen e Ditës së Verës, vazhdojnë ritet që kanë të bëjnë me qepjen e të ligave (nyje që qepet me pe të kuq në pjesën e poshtme të veshmbathjes së epërme) e që realizohet përmes formulës verbale magjike: *çepi gojën e xharpnit ene bollës, çepi gojën e ujkut, çepi gojën e dushmanit, etj...*Kjo formulë magjike që zakonisht pëshpëritet nga nëna – ekzekutuese e këtij aktiviteti, bën pjesë në kuadër të magjisë pozitive e cila mbështetet në parimin "bëre këtë e këtë, të të ndodh kjo e kjo".

Janë me interes edhe të dhënat që i jep Neshat Mehmedi lidhur me

¹ ia mbylli

² magji

praktikimin e këtij veprimi magjik, përkatësisht që ndërlidhet me veroren në fshatrat e malësisë së Sharrit (Bozovcë, Veshallë, Brodec, Vejcë, Shipkovicë, Lisec, Gajre). Ai thekson si vijon: “në Ditën e Verës, vajzat dhe nuset e reja që janë të shëndetshme dhe që i kanë prindërit gjallë zgjohen herët dhe tjerin penj të hollë nëpërmjet furkës. Peri tjerret terma (përpjetë). Pasi e tjerin perin e bardhë, marrin pe të ngjyrës së kuqe dhe të dy bashkë i tjerin përpjetë deri në përfundim të materialit që do të përdoret për festë”. I njëjti autor më tej shton se “fëmijët, qoftë vajza apo djem presin në radhë, kuptohet sipas ardhjes për të vendos penj. Penjtë më parë i vendosin në dorën e djathtë, pastaj në të majtën dhe në qafë. Secilit fëmijë i vendosin penj aq sa anëtarë numëron familja e tij e ngushtë. Pra, bartin penj për vetveten, babain, nënën, motrën, vëllain, etj. Duhet theksuar se penjtë vendosen gjithmonë tek e jo çift. Vajza apo nusja i pyet paraprakisht se për kë vendosin penj, kurse fëmijët përgjigjen duke i numëruar të gjitha anëtarët e familjes”.³ Gjithnjë sipas Neshat Mehmedit, penj në duar vendosin nuset, vajzat e të tjerët me përjashtim të burrave. Për burrat penjtë i vendosin bashkëshortet e tyre, qofshin burrat në shtëpi apo në kurbet. Beqarët vendosin pe vetëm për veten dhe të dashurën apo të fejuarën, por këtë nuk e shprehin hapur se është turp për mjedisin ku jeton, por prapsepapë edhe djemtë kanë vënë penj dhe i kanë mbajtur të fshehur. Pra i kanë vendosur në pjesën e sipërme të krahut. Nuset i kanë vendosur vetëm në duar e në raste të rralla i kanë mbajtur edhe në qafë. Në qafë kanë vënë vetëm për veten dhe bashkëshortin, dy penj e jo më shumë (gjithnjë numri i penjve të përgjithshëm të jetë tek – bashkë me të duarve). Penjtë vendosen në duar dhe qafë gjithnjë tek e jo çift, si te gjinia mashkullore ashtu edhe te gjinia femrore. Qëllimi është që të rinjtë kur të martohen – të trashëgohen, pra të lindin fëmijë, thekson Neshat Mehmedi në punimin e tij dedikuar kremtimit të Ditës së Verës në fshatrat e

³ http://www.zemrashqiptare.net/news/id_42258/Neshat-Mehmedi:-Dita-e-Verës.html

malësisë së Sharrit të Tetovës. Po sipas autorit të njëjtë, penjtë e tillë mbahen shtatë ditë, përkatësisht deri në Ditën e Verës kur hudhen në ndonjë vijë uji, apo lum. Përderisa në rajonin e malësisë së Sharrit, verorja mbahet një javë, në rajonin e Kërçovës, fëmijët e mbajnë veroren, apo smilkeshin deri në ditën e Shëngjergjit (Murati, 2008: 188).

Ndërkaq, në fshatrat toske të Strugës, sipas shënimeve që i jep Bexhet Asani, nëna në mbrëmje përgatit martinkën me pe të kuq dhe të bardhë. Penjtë përdridhen dhe në to vihen monedha të vjetra të shpuara. Veroren me monedha të vjetra, fëmijët e varin në qafë, kurse anëtarët tjerë të familjes vënë martinkë në bylyzik të dorës me qëllim që dora të mos pushojë së punuari gjatë verës. Martinkë vënë edhe te gishti i madh i këmbës së djathtë që të mos pengohen e të rrëzohen. Fëmijët porositen që t'i heqin martinkat posa t'i shohin zogjtë shtegtarë dhe t'i vënë në degë të trëndafilit (Asani, 2012: 21). Po ashtu edhe në fshatrat e Prespës, apo më konkretisht në fshatin Kranjë të Prespës “një ditë para Ditës së Verës, në mbrëmje para se të perëndojë dielli, marrin pe të kuq dhe të bardhë dhe i tjerrin. Ky pe dyngjyrësh që në këtë anë quhet “verojkë”, u vihet të gjithëve, pa dallim moshe. Verojka mbahet e lidhur në dorë, në qafë ose në këmbë deri sa të mbërrijnë dallëndyshet e para. Atëherë i nxjerrin dhe i varin në degë trëndafil duke kënduar: *Dallëndyshe, veshkëlyshke, / nai verojkat, shpirmni n’det, / sillmë bukë edhe shëndet!* (Gega–Musa, 2012: 50). Edhe në rajonin e Pelagonisë (fshatrat shqiptare të Prilepit dhe Krushevës), sipas të dhënave të Mustafa Ibrahimit, me rastin e Ditës së Verës, fëmijët (pa dallim gjinie) te bylyzikët dhe në qafë, lidhin penj të dredhur me ngjyrë të kuqe dhe të bardhë. Këta penj i quajnë martinka, e disa verore. Veroret nxirren ditën e Shën Gjergjit. Në kohëra të lashta, tekstet kanë pasur karakter praktik, siç janë vargjet drejtuar dallëndyshes për ta shpënë veroren (në rrethin e Prilepit dhe Krushevës quhen martinkë) anës detit që t’u sjell njerëzve shëndet ose ndonjë peshqesh: *dallnajshk – dallnajshk, / molle kuqe / na ni martink / nam ni knajsh* (Cërnilishtë)

(Ibrahimi, 2003: 30). Edhe në fshatin malor Patishkë të Shkupit ekziston verorja, por e cila emërtohet *peçat*. Në të vërtetë bëhet fjalë për metelik që shpohet në mes ku futen penjtë e përdredhur me ngjyrë të bardhë dhe të kuqe (fig. 2). Ky metelik varet në qafë nga fëmijët të cilët pastaj me këtë nishan shkojnë shtëpi më shtëpi dhe shpërblehen me vezë. Nëse ndonjë fëmijë nuk e kishte të varur në qafë *peçatin*, atëherë i thuhej se nuk do t'i jepej vezë pasi i mungonte nishani i Ditës së Verës.⁴ Edhe në këtë fshat verorja mbahet deri në Ditën e Shëngjergjit kur ajo lidhet për ndonjë degë të kulprës me dëshirën që kjo bimë t'ua marr të ligat e vitit në vazhdim⁵.



Fig. 2
Verorja me metelik nga fshati Patishkë i Shkupit

Nga e gjithë kjo që u tha më sipër, pa asfarë pretendimi se janë dhënë të gjitha aktivitetet magjike dedikuar verores te shqiptarët e Maqedonisë, mund të konkludohet se përgjithësisht kemi të bëjmë me aktivitete pak a shumë të ngjashme. Dallime të

⁴ Daut Mehmeti, i lindur më 1959 në Patishkë të Shkupit.

⁵ Bukurije Mustafa, *Dita e Verës – Relikt kulturor në fshatin Patishkë të Shkupit*, faqe, 3, (punim në dorëshkrim).

vogla vërehen vetëm sa i përket pjesës së trupit ku vendoset verorja, si dhe vendit ku ajo braktiset më vonë pas mbarimit të aktivitetit magjik, nënkuptohet edhe kohëzgjatjes të mbajtjes së saj që diku është tri ditë e diku vazhdon deri në festën tjetër pagane të Shëngjergjit. Po ashtu edhe akti i ndërlidhjes së verores me shpezët shqetësojnë dikur është i pranishëm, kurse diku mungon.

3. Interpretimi i aktiviteteve magjike që ndërlidhen me veroren

Nga vargu i aktiviteteve magjike që ndërlidhen me veroren me siguri se rëndësi të dorës së parë paraqet interpretimi i ngjyrës së kuqe dhe të bardhë, përkatësisht ngjyrat e fijeve të penjve prej të cilave përbëhet ajo. Nënkuptohe se në këtë drejtim, posaçërisht një rol të rëndësishëm luan ngjyra e kuqe e cila është tejet e rëndësishme në të gjitha kulturat me taban tradicional. Kjo ngjyrë ka realizim të dyfishtë pasi mund të haset në dy çifte opozitare, apo kundërvënës, përkatësisht të krijojë kundërvënien edhe me ngjyrën *e bardhë*, por njëkohësisht edhe me *të zezën*. Me këtë rast krijohet triada mjaft e përhapur e ngjyrave: *e bardhë – e kuqe – e zezë*. Pozicioni i ngjyrës së kuqe ndërmjet ngjyrës së bardhë dhe ngjyrës së zezë është i ngjashëm me pozicionin *e hijes* që ka në triadën *dritë – hije / errësirë* me ç'rast hija paraqitet në marrëdhënie të dyfishtë – ajo njëherit është në baza kundërvënës me dritën, por megjithatë nuk është errësirë.

Në aspektin semantik, kjo triadë (*e bardhë – e kuqe – e zezë*) në tekstet me prapavijë magjike (por edhe në gjerë) realizohet në cilësinë e *ditës* – mëngjesi para lindjes së diellit që identifikohet me ngjyrën *e bardhë*, kurse mbrëmja pas perëndimit të diellit identifikohet me ngjyrën *e kuqe*. Nënkuptohe se *nata* identifikohet me ngjyrën *e zezë*. Nga kjo rezulton se ngjyra *e bardhë* që identifikohet me mëngjesin dhe ngjyra *e kuqe* që identifikohet me mbrëmjen kanë rol të ndërmjetëm pasi qëndrojnë diku mes

ndërrimit të natës me ditën dhe anasjelltas – mes ndërrimit të ditës me natën. Nga e gjithë kjo mund të konkludohet se ngjyra e bardhë dhe e kuqe kanë rolin e mediatorit, apo ndërmjetësit, përkatësisht të kalimit nga një periudhë kohore në një periudhë tjetër kohore. Pra, ngjyra e bardhë identifikohet me mëngjesin dhe vazhdimësinë e ditës, kurse e kuqja identifikohet me mbrëmjen dhe vazhdimësinë e natës.

Si rrjedhojë e kësaj që u tha më sipër, mund të ketë ndodhur që njeriu me bindje pagane me qëllim që t'i sjell gjërat në kufirin e thjeshtësisë së perceptimit të realitetit objektiv, me siguri se triadën e ngjyrave të mësipërme e ka reduktuar në një kundërvënie dyshe me ç'rast është eliminuar një ngjyrë, përkatësisht ngjyra e zezë. Në rastin tonë konkret dihet se ngjyra e kuqe e verores, mund të alternohet, apo zëvendësohet me një varg ngjyrash dhe nuanca të errëta, madje që gravitojnë deri te ngjyra e zezë, por ngjyra e kuqe asesi nuk mund të alternohet me ngjyrën e bardhë. Pra, ngjyra e kuqe mund të realizohet edhe nëpërmjet paradigmës *e ngjyrosur, e errët*, që mund t'i kundërvihet *dritës*, apo *të bardhës*. Pra, ngjyra e kuqe duke i përthithur edhe tiparet e ngjyrës së zezë duhet të perceptohet si ngjyrë e natyrës ktonike, përkatësisht e botës tokësore, apo nëntokësore, ashtu siç perceptohet edhe nata (kohë e përshtatshme për veprimin e qenieve të natyrës ktonike që mund ta dëmtojnë njeriun), nënkuptohet duke pasur parasysh logjikën tradicionale të vrojtimit të realitetit objektiv, gjithmonë mbi baza të kundërvënies dyshe. Nga ana tjetër, ngjyra e bardhë, (si antipod i së kuqes), duke u identifikuar me mëngjesin shënon fillimin e ditës, apo të një perspektive të re jetësore.

Nëse i kthehemi edhe njëherë triadës së ngjyrave *e zezë – e bardhë – e kuqe* pa marr parasysh radhitjen e tyre, duhet të themi se kemi të bëjmë me një strukturë simbolike të kalimit nga një gjendje jo e volitshme në një gjendje tjetër të volitshme, përkatësisht kemi të bëjmë me një strukturë simbolike të kalimit në një gjendje të re. Në rastin tonë konkret, *e zeza* do t'i përgjigjej gjendjes së sëmurë

ose cënimit të ndonjë rendi, *e bardha* – shërimit ose kthimit në gjendje fillestare të rendit, apo harmonisë, kurse *e kuqja* – kufirit, apo kohës së fillimit të kthimit të fuqive të papastra, apo të liga në hapësirën e tyre vepruese. Në këtë mënyrë, në këtë triadë, kemi kundërvënien dyshe: *e zezë* – *e bardhë* e cila është transformuar në kundërvënien tjetër dyshe: *e kuqe* – *e bardhë*, përkatësisht në ngjyrat konkrete të cilat i posedon verorja. Së këndejmi, në frymën e logjikës arkaike që i veneron gjërat kryesisht nga aspekti i kundërvënieve dyshe, kemi ngjyrat e verores (*e kuqe* – *e bardhë*) me ç’rast ngjyra e kuqe identifikohet, apo alternohet njëkohësisht edhe me të zezën. Nga e gjithë kjo mund të konkludohet se ngjyra e kuqe që alternohet edhe me të zezën, paraqet periudhën e lig, apo të pavolitshme, ashtu siç është edhe nata, kurse ngjyra e bardhë paraqet agimin, përkatësisht lindjen e një dite të re që identifikohet me kohë të volitshme kur qenia njerëzore vazhdon me aktivitetet e zakonshme punuese. Duhet thënë se alternimi i ngjyrës së zezë me të kuqen është i njohur edhe në traditat e popujve shumë të lashtë që qëndrojnë më afër kulturës burimore. Kështu etnologu i njohur Viktor Tarnier duke folur për rolin e ngjyrave në traditën e një fisi të lashtë, të njohur me emrin Ndembu që jeton në Zimbabve thekson se edhe përkundër faktit se kundërvënia dyshe *bardhë* / *zi* është kryesorja në fisin në fjalë, megjithatë ngjyra e zezë mungon gjatë aktiviteteve rituale, apo magjike duke u alternuar, apo zëvendësuar me ngjyrën e kuqe. Andaj mund të thuhet se në ritualet e këtij fisi kundërvënia kryesore është ajo mes ngjyrës së kuqe dhe ngjyrës së bardhë. E bardha ka si zakonisht konotacione pozitive, kurse e zeza konotacione negative (sipas Delijezh, 2012: 296).

Në rastin tonë konkret, përkatësisht në ngjyrat e verores (kuq e bardhë) mund të venerohen dy gjëra në baza antipode që në aspektin makrokozmetik mund të ndërlidhen me dy periudha kohore kalendarike, përkatësisht me dimrin që identifikohet me kaosin, apo vdekjen dhe me verën që identifikohet me kozmosin, përkatësisht

lindjen e një bote të re. Në të vërtetë, verorja me ngjyrat e saja (kuq e bardhë) është e pranishme pikërisht në një ditë që shënon mbarimin e një viti kalendarik që identifikohet me dimrin, apo kohën e lig që i përgjigjet ngjyrës së kuqe, apo të zezë dhe njëkohësisht fillimit të një viti të ri kalendarik, përkatësisht fillimit të një jete të re që gjithsesi identifikohet me ngjyrën e bardhë. Ngjyrat në fjalë, përkatësisht ngjyra e bardhë mund të simbolizoj edhe këtë botë (botën njerëzore), kurse ngjyra e kuqe që alternon, apo zëvendëson edhe të zezën mund të simbolizoj edhe botën tjetër, apo botën nëntokësore (hyjnitë ktonike).

Ndërkaq duke pasur parasysh faktin se njeriu me bindje pagane çdoherë në vlerësimin e gjërave që i dedikohen realitetit objektiv është nisur nga vetvetja, atëherë lirshëm mund të themi se edhe në bazën e venerimit të dukurive kozmike qëndron konceptimi antropologjik, përkatësisht përvoja që buron prej këtij të fundit. Madje në këtë drejtim është edhe më i qartë gjykimi i etnologut të njohur Viktor Tarnier i cili në bazë të hulumtimeve të kryera në fisin Ndembu të Zimbabvesë konkludon se “trupi njerëzor paraqet bazën e çdo klasifikimi tjetër. Si rrjedhojë, edhe klasifikimi i ngjyrave ndjek një logjikë të kësaj natyre, përkatësisht ka si bazë veçoritë, apo përvojën e trupit të njeriut. Kështu, ngjyra e bardhë dhe ngjyra e kuqe marrin attribute antropologjike. Në të vërtetë, ngjyra e bardhë ndërlidhet me spermën dhe venerohet si ngjyrë e parimit mashkullor, kurse ngjyra e kuqe ndërlidhet me gjakun, përkatësisht ciklin menstrual dhe venerohet si ngjyrë e parimit femëror, apo më konkretisht, sipas Tarnierit, kemi të bëjmë me grupin patrilinear që i referohet babait dhe grupin matrilinear që i referohet nënës (sipas Delijezi, 2012: 299). Nga kjo rezulton se lidhjet farefisnore të babait ndërlidhen me ngjyrën e bardhë, kurse ato të nënës si zakonisht me ngjyrën e kuqe.

Pra, nëse shprehemi me gjuhën e simboleve, atëherë ngjyra e kuqe është e ndërlidhur me parimin femëror, kurse ngjyra e bardhë

gjithsesi me parimin mashkullor. Ndoshta në mënyrë më eksplicite, një konstatim i kësaj natyre mund të vërehet në një verore që e huazuar nga tradita e bullgarëve (shiko. fig. 3) e që me siguri se nuk duhet të mungojë edhe në traditën tonë, pasi pothuajse në të gjitha ritet e ciklit antropologjik, por edhe kalendarik që shënojnë kalim në një periudhë të re kohore kemi si element të domosdoshëm gërshetimin e parimit femëror dhe mashkullor që nënkupon me siguri ndjelljen e pjellorisë, qoftë në aspektin antropologjik, qoftë në atë kalendarik, përkatësisht ndjelljen e pjellorisë së prodhimeve bimore, si tejet të vlefshme për sigurimin e ekzistencës biologjike të njeriut të lashtë. Po ashtu duhet theksuar se sipas botë-kuptimit patriarkal, ngjyra e bardhë, apo parimi mashkullor ndërli-dhet edhe me të pastrën, pasi graviton kah qiellorja, apo hyjnorja, kurse ngjyra e zezë që alternohet me të kuqen, apo me parimin femëror (ciklin menstrual, apo gjakun) ndërli-dhet me të papastrën, pasi graviton kah tokësorja, apo djallëzorja, përkatësisht kah fuqitë me attribute ktonike.



Fig. 3

Verore me bazë antropomorfe

Nga e gjithë kjo që u theksua më sipër rezulton se penjtë e përdre-dhur me ngjyrë të kuqe dhe të bardhë paraqesin edhe simbole të dy parimeve të kundërta (mashkullore dhe femërore) qoftë kozmo-

logjike, apo antropologjike nga kryqëzimi i të cilëve buron embrioni i çdo jete të re, madje edhe i ciklit veror që identifikohet me parimin femëror, pasi nënkupton kohën e “lindjes” së prodhimeve bimore nga toka e mbetur “shtatzënë” gjatë muajve të dimrit. Madje në këtë drejtim, hartuesit e njohur të fjalorit të simboleve, Chevalier dhe Gheerbrant, janë edhe më konkretë duke theksuar se ngjyra e kuqe duke u identifikuar me natën, identifikohet po ashtu edhe me pjesën nëntokësore, përkatësisht atanorin, apo laboratorin alkimik ku zihet, piqet dhe mëkëmbet fara e çdo qenie, duke aluduar edhe në farën bimore, aq të rëndësishme për mbijetesën e njeriut të lashtë. Si rrjedhojë, ngjyra e kuqe duke u identifikuar me pjesën nëntokësore të tokës paraqet fshehtësinë, apo misterin e jetës së fshehur në thellësitë e tokës. Kjo është ngjyra e shpirtit të padukshëm, libidos dhe zemrës (Chevalier – Gheerbrant, 1983: 79). Pra, ngjyra e kuqe i referohet parimit femëror që identifikohet me tokën nga e cila lindin prodhimet bujqësore. Kjo nënkupton se toka e mban të fshehur, apo në njëfarë mënyre, të vdekur farën e mbjellë në brendinë e saj që më vonë ta ringjall atë dhe ta nxjerr mbi sipërfaqen e vet. Duke i poseduar këto veçori, ngjyra e kuqe përdoret si zakonisht edhe gjatë riteve të ashtuquajtura të rishtarisë dhe ndërlihet me vdekjen dhe ringjalljen simbolike të rishtarëve. Kështu, rishtarët që identifikoheshin me misterin e Kibelës futeshin në një humnerë tokësore ku stërpikeshin me gjakun (ngjyrën e kuqe) e demit ose dashit që sakrifikoheshin ritualisht mbi humnerë. Stërpikja me gjak, apo me ngjyrë të kuqe, sidomos në humnerë nënkuptonte vdekjen, por më vonë edhe ringjalljen e rishtarëve, ashtu siç është edhe fati i farës që ringjallet nga brendia e botës nëntokësore. Pra, ngjyra e kuqe nënkupton padyshim vdekjen e një periudhe kohore që ndërlihet me statusin shoqëror të qenies (fazën e fëmijërisë), por më vonë edhe ringjalljen, apo lindjen e re (fazën e pubertetit, por edhe fazën e burrërisë dhe nusërisë). Një logjikë e kësaj natyre mund t'i përshkruhet edhe ngjyrës së kuqe që dominon në veshjen popullore të nuseve të reja ndër ne, por edhe më gjerë. Në këtë rast, prania e kësaj ngjyre nënkupton ndjelljen magjike të

lindjes së re, nënkuptohet të fëmijëve. Me siguri se ngjyra e kuqe do të kishte funksionin e njëjtë magjik edhe me rastin e pranisë së saj gjatë Ditës së Verës kur shënohet kalimi në një periudhë të re kohore kalendarike.

Megjithatë edhe përkundër konstatimeve të mësipërme duhet theksuar se objektet, apo gjësendet, por edhe qeniet e gjalla, sidomos ato që ngërthejnë në vetvete attribute mitike, nënkuptohet gjithnjë sipas botëkuptimit pagan, karakterizohen me tipare ambivalente që mund t'i referohen tërthorazi edhe verores, përkatësisht ngjyrave të saj. Kështu, hartuesi i një enciklopedie të simboleve tradicionale, Kuper thotë se “e bardha është e ndërlidhur si me jetën dhe dashurinë, po ashtu edhe me vdekjen dhe varrimin. Me rastin e kurorëzimit simbolizon vdekjen e jetës së kaluar dhe njëkohësisht lindjen e një jete të re, kurse në vdekje paraqet po ashtu lindjen e një jete të re, por në botën tjetër (Kuper, 1986: 16). Kjo mund të ndërlidhet edhe me pëllhurën e bardhë (qefinin) me të cilin mbështillet kufoma e të vdekurit gjatë varrimit, veçmas në pjesën myslimane shqiptare. Studiuesi Kuper jo vetëm që ngjyrën e bardhë e ndërlidh me vdekjen, por edhe kombinimin e saj me ngjyrën e kuqe po ashtu e ndërlidh me vdekjen (Kuper, 1986: 17). Duke pasur parasysh ngjyrat e verores (kuq e bardhë), atëherë kjo mund t'i referohet vdekjes, përkatësisht mbarimit të një periudhe kohore, siç është ajo e dimrit.

Nga ana tjetër, jo vetëm ngjyra e bardhë, por edhe ajo e kuqe ka tipare ambivalente. Autorët e fjalorit të sipërpërmendur, Chevalier dhe Gheerbrant theksojnë se ekzistojnë dy ngjyra të kuqe: njëra që ndërlidhet me natën, femrën, apo me fuqinë tërheqëse centripetale, kurse tjetra që ndërlidhet me fuqinë centrifugale, apo ditore, mashkullore, përkatësisht me energjinë diellore që gjithçka ndriçon me fuqinë e saj të madhe dhe të papërballueshme. Pra, ngjyra e kuqe duke u identifikuar me dritën e ditës, përkatësisht me diellin merr cilësi që ndërlidhen me parimin mashkullor dhe solar. Duke u paraqitur në ndërlidhje me ngjyrën e bardhë, ajo shndërrohet edhe në simbol kryesor të fuqisë jetësore. Ajo si e tillë personifikon

epshin e dashurisë dhe bukurinë, impulsivitetin dhe fuqinë e madhe, si dhe lirinë dhe fitoren e Erosit. Ajo mishëron edhe aftësitë luftarake. Me një fjalë, kundruar nga aspekti centrifugal, ngjyra e kuqe paraqet simbol të rinisë, shëndetit, begatisë dhe dashurisë. Si e këtillë, ajo paraqet pra kryesisht simbol të shëndetit pasi ndër ne ekziston shprehja *i kuq në fytyrë* që i referohet ndonjë personi të shëndoshë. Edhe disa formula verbale magjike që i përmendëm më sipër në lidhje me veroret me siguri se i referohen ndjelljes magjike të shëndetit për të gjithë anëtarët e familjes. Nga ana tjetër edhe në ngjyrën e bardhë mund të vërehet simbolika ambivalente. “E bardha është e ndërlidhur me jetën dhe dashurinë, por njëkohësisht edhe me vdekjen, apo varrimin” (Kuper, 1986: 16).

Një tjetër element i rëndësishëm që i referohet aktivitetit magjik të verores është theksimi i anës së djathtë si anë preferuese me rastin e vendosjes së verores (në gishtin ose bylyzikun e këmbës dhe dorës së djathtë). Në shumë fise arkaike, ana e djathtë ndërlidhet kryesisht me të mirën, fuqinë, shkathësinë, drejtësinë, etj., kurse ana e majtë me idetë e kundërta. Te maorët, thekson studiuesi Herc, ana e djathtë është e shenjtë, paraqet strehimore të fuqive bëmirëse dhe krijuese, ajo është thjeshtazi ana e jetës, kurse e majta paraqet anën profane, anën e fuqive të errëta dhe të dyshimta, apo me një fjalë – vdekjen. Përderisa e djathta paraqet lartësinë, botën e epërme, apo qiellore, ana e majtë ndërlidhet me botën e ulët dhe si zakonisht me tokën (Deljezh, 2012: 92). Pra, ana e djathtë paraqet fuqinë e shenjtë, burimin e jetës, anën e lëvizjes diellore – cilësi këto që gjithsesi i kundërvihet anës së majtë, si anë më e dobët dhe njëherit më inferiore. Cilësitë e këtilla të dy anëve në fjalë kanë prodhuar edhe besime të natyrave të ndryshme. Në këtë funksion besohet se fuqitë me atribute të mbinatyrshme çdoherë vijnë nga ana e djathtë, kurse në vendet e shenjta hyhet çdoherë me këmbën e djathtë. Në ritet mortore dominon ana e majtë, kurse në ritet në të cilat ndillet pjelloria, sidomos në ato të dasmës dominon si zakonisht preferenca e këmbës, apo dorës së djathtë. Nga kjo rezulton se njeriu është

qenie e dyfishtë – *homo duplex* – ai ka ekstremite (duar dhe këmbë) të kundërta – të djathtën dhe të majtën. Dy anët e kundërta në fjalë duke u bazuar në shkallën e fuqisë së tyre, sipas konceptit tradicional, prodhojnë edhe kundërvënie dyshe në aspektin gjinor, përkatësisht e djathta ndërlidhet me gjininë mashkullore, kurse e majta me gjininë femërore. Kjo kundërvënie e ndërlidh gjininë mashkullore me të jashtëzakonshmen, apo me të shenjtën (sakralen), kurse gjininë femërore me të zakonshmen (profanen). Si rrjedhojë e një logjike të tillë, në aktivitetet fetare me natyrë hyjnore mungon gjinia femërore e cila duke qenë me natyrë të dobët fizike kërkon hakmarrje vetëm nëpërmjet ushtrimit të aktiviteteve magjike që janë të rezervuara si zakonisht vetëm për më të dobëtin.

Një tjetër element i rëndësishëm që ndërlidhet me veroret ka të bëjë me vendosjen e tyre në lloje të ndryshme të botës bimore. Në të vërtetë, ato pas përdorimit vendosen në degë thane, në kulpër ose menjëherë pas shikimit të ndonjë dallëndysheje në fluturim vendosen edhe në ndonjë degë trëndafili. Vendosja e tyre në thanë i referohet faktit se ky dru është shumë i fuqishëm, andaj akti i tillë ndërlidhet me magjinë imitative, përkatësisht kërkohet që atributet e saja të barten edhe tek anëtarët e familjes, përkatësisht të ndillet fuqia trupore si bazë e patjetërsueshme e një shëndeti solid. Në këtë kontekst duhet theksuar se thanës nuk mund t'i mohohet edhe roli ndërmjetës, apo kufitar në arealin hapësinor në të cilin zhvillohet. Ajo është një dru kufitar që rritet mes fushës dhe malit, kurse po ashtu ka lidhje edhe me ngjyrën e kuqe, ashtu siç është edhe njëra ngjyrë e verores. Pra, përderisa thana ndan arealin hapësinor, atëherë Dita e Verës ndan arealin kohor, si ditë mes dimrit dhe verës. Thana po ashtu paraqet një pemë e cila më herët lulëzon, kurse më vonë piqet. Në disa vise tona, thana shërben edhe si mjet ritual me të cilën preken anëtarët e familjes me siguri për të bartur fuqinë frytdhënëse të ndonjë hyjnie që mishëron vdekjen dhe njëkohësisht edhe ringjalljen.

Ndërkaq, prania e trëndafilin në aktivitetin magjik të veroreve ka të bëjë me faktin se kjo bimë mund të haset në cilësinë e dy ngjyrave kryesore, përkatësisht me ngjyrat e verores (bardhë e zi). Duke qenë i tillë, trëndafili është simbol i dashurisë, por njëkohësisht edhe i vdekjes, apo simbol i lindjes së sërishme mistike. Në mitologjinë greke, trëndafili dhe anemoni mugulluan nga gjaku i derdhur i Dionisit përderisa ky perëndi po jepte shpirt. Në këtë kontekst nëse përkujtojmë edhe disa përmbajtje të baladave tona popullore në të cilat mbi varrin e heroit tragjik mbin ndonjë pemë, ndonjëherë edhe trëndafil, atëherë bëhet edhe më i qartë fakti i ndërlidhjes mes bimës, apo trëndafilin me varrin. Si simbol i varrit, trëndafili mishëron jetën e amshueshme, pranverën e përherëshme dhe njëherit edhe ringjalljen. Trëndafili njëkohësisht është edhe simbol i dashurisë, gëzimit, bukurisë dhe epshit. Në mitologjinë greko-romake, bima në fjalë ishte simbol i perëndeshës Afërditë, përkatësisht i Venerës (Kamings, 2004: 215). Në të vërtetë, edhe në ngjyrat e trëndafilin gërshetohet simbolika e ngjyrave të verores që përgjithësisht paraqesin vdekjen dhe lindjen e një jete të re, apo mbarimin e dimrit dhe fillimin e një kohe të re, siç është ajo e periudhës verore. Në funksion të ngjashëm është edhe bima e kulprës ku varen veroret pas përfundimit të aktivitetit magjik. Edhe kulpra si një bimë që përdridhet rreth një bime tjetër është po ashtu e karakterit kufitar, pasi ajo nuk posedon as cilësitë e drurit, por as cilësitë e ndonjë bime të ulët, por qëndron diku në mes, andaj si e tillë, apo si e ndër-mjetme merr rolin mes botës njerëzore dhe qenieve misterioze, apo të rrezikshme me prapavijë mbinaryore. Edhe kjo bimë karakterizohet me lule të bardha në të kuqe që asocojnë edhe me ngjyrat e verores. Ndërkaq, vendosja e hudhrës në verore ka funksion mbrojtës, pasi ajo kundërmon aromë të keqe, andaj synimi i saj është dëbimi i fuqive të liga që mund t'i dëmtojnë anëtarët e familjes, veçmas kur ndodh ndonjë tranzicion në aspektin kohor kur prania e këtyre fuqive të liga është tejet e madhe. Nga ana tjetër, prania e metelikëve në verore është e natyrës mimetike, pasi ndjell të mirën, apo shëndetin duke pretenduar që edhe jeta e anëtarëve të familjes

të jetë e fuqishme, ashtu siç është edhe meteliku. Ndërlidhja e veroreve me dallëndyshet ka të bëjë me atë se këto të fundit, janë paralajmëruese të verës, apo simbolizojnë fatin dhe pjellorinë. Shkuarja dhe ardhja e saj, por edhe ngjyra (zi e bardhë) me të cilën është e pajisur ajo, apo dallëndyshja ndikojnë që të marr përmasa të një simbolike që përfaqëson baraspeshën e kundërvënies. Në të vërtetë, ardhja e dallëndyshit simbolizon verën, kurse shkuarja simbolizon ardhjen e dimrit. Pra, edhe ky shpend, por edhe lejleku kanë funksionin e njëjtë simbolik.

Edhe hapësira e përgatitjes së verores ka të bëjë me kufij që simbolizojnë këtë botë dhe botën tjetër, përkatësisht qeniet me prapavijë demoniake. Verorja theksuam më herët se përgatitet nën strehën e shtëpisë e cila paraqet areal që shënon kundërvënien dyshe mes *kulturës* (të cilës i përket shtëpia) dhe *natyrës* (të cilës i përket zona jashtë shtëpisë). Nënkuptohe duke qenë një zonë e ndërmjetme, sidomos gjatë natës ajo është e preferuar për qëndrimin e fuqive demoniake. Pra, edhe hapësira si zonë e ndërmjetme i përgjigjet simbolikës së verores si objekt i ndërmjetëm që ndërlidh dy periudha kohore. Po ashtu edhe vatra në të cilën përgatitet verorja është një objekt i ndërmjetëm që ndërlidh këtë botë me botën tjetër. Ajo me pjesën e saj që shtrihet në tokë ndërlidhet me botën e poshtme, kurse me pjesën e saj mbi tokë ndërlidhet me këtë botë, por njëkohësisht nëpërmjet hapjes së saj në kulmin e shtëpisë, përkatësisht nëpërmjet tymit që përçohet mbi shtëpi, ajo ndërlidhet edhe me botën qiellore, apo botën e perëndive (më gjerësisht, Murtezani, 2001: 171–178). Pra, vatra, nëse i referohemi besimit tradicional, paraqet objekt kalimi që ndërlidh botën tonë me dy botët tjera, përkatësisht botën e poshtme, apo nëntokësore dhe botën e epërme, apo qiellore, ashtu siç paraqet edhe verorja një lloj kalimi në një periudhë të re kohore, apo më konkretisht nga periudha dimërore në atë verore.

4. Përfundim

Në vija të përgjithshme mund të konkludohet se verorja pothuajse në të gjitha trevat shqiptare të Maqedonisë paraqet një njet tejet të rëndësishëm në kuadër të praktikave magjike dhe rituale që ushtrohen veçmas me rastin e shënimit të festës kalendarike të Ditës së Verës. Dy ngjyrat e verores, përkatësisht e kuqja dhe e bardha ngërthejnë në vetvete një simbolikë tejet të begatshme që ndërlihet kryesisht me ndjelljen magjike të shëndetit dhe të pjellorisë në jetën e njeriut me botëkuptim pagan. Në këtë drejtim spikat veçmas ngjyra e kuqe, përdorimi magjik i së cilës në të kaluarën e lashtë ka qenë edhe me përmasa tragjike. Studiuësja Shubert duke iu referuar këtij fakti thotë se “më herët me siguri se në vend të ngjyrës së kuqe është përdorur gjaku njerëzor me qëllim që të dëbohen gjërat e liga. Që në antikë është përdorur gjaku si mjet profilaktik dhe si ilaç i shërimit. Për këtë dukuri jep të dhëna Plini. Me këtë rast është besuar se gjaku i të vdekurit është tejet shërues, andaj njerëzit vriteshin që gjaku i tyre të përdorej për qëllime magjike. Pra, qysh nga kjo kohë vërehet se ngjyra e kuqe, apo ngjyra e gjakut, përdoret edhe më tej në funksion të njëjtë (Schubert, 1984: 135).

Në një fazë më të hershme të zhvillimit njerëzor, përkatësisht në atë preanimiste është besuar se ngjyra e kuqe në mënyrë të ngjashme si edhe zjarri, vetëtima, dielli dhe gjaku, akumulon, por njëkohësisht edhe rrezaton një lloj energjie e cila i zbraps shpirtërat e ligë, apo me prapavijë demoniake. Duke pasur parasysh faktin se forcat demoniake, sipas besimit tradicional, depërtojnë në trupin e njeriut nëpërmjet ekstremiteteve (duarve, këmbëve, qafës), atëherë veroret janë vendosur pikërisht në këto organe trupore kryesisht në cilësinë e një mburoje magjike. Edhe panja fizike e veroreve në trajtë të rrethit ka po këtë funksion, përkatësisht të shërbejë si një mur mbrojtës i pengimit të depërtimit të fuqive të liga në trupin e njeriut. Ndonjëherë ngjyra e kuqe duhet të tërheq edhe vëmendjen

e sykeqit. Ky i fundit përqëndron shikimin e tij te ngjyra e kuqe e perit dhe kështu energjia e dëmtshme e shikimit të tij shkarkohet fillimisht mbi veroren duke anashkaluar organet tjera vitale të trupit të njeriut.

Megjithatë, esenca e funksionimit të ngjyrave të veroreve qëndron në kombinimin e tyre, përkatësisht në kundërvënien e tyre që krijon një harmoni, apo unitet të llojit të vet. Dihet se ritet e kalimit që shënojnë depërtimin në një periudhë të re kohore, ashtu siç është edhe Dita e Verës, karakterizohen me simbole të vdekjes dhe lindjes së re, pasi bëhet ndërrimi i dy periudhave, apo cikleve kohore. Në të vërtetë, përfundon periudha e dimrit që karakterizohet me simbole të vdekjes, kurse fillon një periudhë e re kalendarike, siç është ajo e verës që gjithsesi se karakterizohet me simbole të lindjes. Në këto periudha kohore që shënojnë kalim, apo tranzicion në një kohë të re, sipas besimit tradicional, është e tejdukshme prania e fuqive të liga, andaj praktikohen magji të ndryshme me qëllim që të neutralizohet rreziku i veprimit të tyre. Nënkuptohe se nëpërmjet praktikave magjike kërkohet ndjellja e pjellorisë, apo e shëndetit, andaj veroret vihen në funksion të arritjes së këtij synimi. Pra, ngjyra e bardhë dhe e kuqe e veroreve paraqet një akt magjik me të cilin dëbohen fuqitë e liga dhe njëkohësisht ndillet shëndeti dhe begatia në të gjitha fushat e jetës. Në esencën e këtyre ngjyrave në cilësinë e një aktiviteti të mirëfilltë magjik qëndron logjika e tejkalimit sa më të lehtë të kësaj faze kritike në të cilën kryqëzohen dy periudha të kundërta kohore, siç janë dimri dhe vera.

Nëpërmjet ushtrimit të aktiviteteve magjike kërkohet nga fuqitë misterioze të mbinatyrshme që ky tranzicion i pikëtakimit të dy periudhave kohore të jetë sa më efikas dhe njëherit në funksion të ndjelljes së shëndetit dhe pjellorisë në periudhën kohore që pason. Në këtë kontekst, pothuajse të gjitha objektet që ndërliken me veroret ngërthejnë në vetvete simbolikën e kalimit në një gjendje të re në të cilën kërkohet të mbretërojë rendi dhe mirëqenia.

Pothuajse në të gjitha ritet e kalimit në të cilat ndodh ndërrimi i statusit të qenies, qoftë ajo e karakterit kalendarik, apo antropolgjik, ashtu siç është rasti edhe me Ditën e Verës, nënkuptohet edhe nëpërmjet simbolikës së verores, del në shesh filozofia e njeriut pagan që fokusohet në triadën e famshme: *lindje – vdekje – lindje e sërishme*. Mund të thuhet lirshëm se i gjithë aktiviteti ritual dhe magjik i njeriut me bindje pagane shtrihet brenda kufijve të kësaj triade qenësore. Me siguri se edhe veroret, përkatësisht ngjyrat e tyre afirmojnë një logjikë të kësaj natyre duke pretenduar të sjellin shëndet dhe pjellori, si bazë e patjetërsueshme e mirëqenies njerëzore.

Bibliografia:

- Asani, Bexhet (2012): *Këngët popullore rituale toske të trevës së Strugës (Studim monografik)*. Strugë.
- Chevalier, J. – Gheerbrant, A. (1983): *Rječnik simbola*. Nakladni Zavod MH. Zagreb.
- Delijež, Rober (2012): *Istorija antropologije*. Biblioteka XX vek. Beograd.
- Eliade, Mircea (1969): *Le mythe de l'éternel retour*. Editions Gallimard. Paris.
- Gega–Musa, Leontina (2012): Ritet e motmotit të ekuinoksit pranveror (Prezantuar me material nga fshati Kranj i Prespës). *Scupi. 1. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore shqiptare në Maqedoni*. ITSHKSH. Shkup.
- Haxhihasani, Qemal (1988): Hyrje. *Lirika popullore, 1. Këngë rituale dhe të punës*. Përgatitur: Qemal Haxhihasani, Kozma Vasili. Instituti i Kulturës Popullore. Tiranë.
- Ibrahimi, Mustafa (2003): *Thesari folklorik shqiptar nga rajoni i Pelagonisë*. Flaka. Shkup.
- Kamings, T. Endru (2014): *Sve o simbolima*. Narodna knjiga “Alfa”. Beograd.
- Kuper, K. Dž. (1986): *Ilustrovana enciklopedija tradicionalnih simbola*. Prosveta – Nolit. Beograd.

- Murati, Qemal (2008): *Kërçova. Hulumtime gjuhësore, etnografike dhe folklorike*. Shkup.
- Murtezani, Izaim (2001): *Në shtjellën e arketipeve (Studime nga folklori dhe etnologjia)*. Shkup. Flaka.
- Qazimi, Azem (2008): *Fjalor i mitologjisë dhe demonologjisë shqiptare. Të krennte, rite e simbole*. "Plejad". Tiranë.
- Schubert, Gabriella (1984): Konac, vrpce i tkanina kao magijska sredstva narodne medicine u Jugoistočnoj Evropi. *Makedonski folklor*. Godina XVII, broj 33. Skopje.
- Selimi – Osmani, Edibe (1996): *Rite e besime popullore në viset e Tetovës dhe të Gostivarit*. Shtëpia botuese "Asdreni". Shkup.
- Xhemaj, Ukë (2005): *Shtresime kulturore*. Instituti Albanologjik i Prishtinës. Prishtinë.

BUKURIJE MUSTAFA

*Bashkëpunëtorë e lartë shkencore, Instituti i Trashëgimisë
Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Shkup*

DITA E VERËS RELIKT KULTUROR NË FSHATIN PATISHKË–KARSHIAKË

1. *Dita e Verës*, që shënohet më 14 mars, ashtu si festat e tjera të kalendarit popullor, shikohen si relikte kulturore, të cilat tani më janë në stadin e shuarjes graduale dhe si të tilla, në pjesë më të madhe, i gjejmë vetëm në kujtimet e njerëzve. Në zonat e izoluara malore, ky proces i shuarjes është më i ngadalshëm dhe banorët e atyre anëve kanë arritur shumë pak t'i ruajnë si gjurmë të festave të dikurshme kalendarike. Kjo ishte shtytje për realizimin e hulumtimit në rrethinë të Shkupit për të dokumentuar dhe për të regjistruar edhe atë pak material që e gjejmë këtyre anëve. Ekspedita hulumtuese të mëhershme nëpër këto fshatra, janë zhvilluar gjatë viteve 1929–1930 nga etnologë e gjuhëtarë serbë, që shikuar nga prizmi kohor dhe trajtimet tendencioze, na bëjnë që të dhënat e këtyre hulumtimeve t'i rishqyrtojmë dhe t'i verifikojmë. Tani qëllimi im i hulumtimit, kërkonte një vështrim krahasues e diakronik, pas një periudhe diku 85 vjeçare.

Ekspedita u realizua më 14 mars 2015, në *Ditën e Verës*, për të parë realisht se a festohet dhe si festohet, duke pasur informacione shumë të pakta paraprake. Fshatarët e dinin këtë datë si shënimin e *Ditës së Verës*, që ndryshon nga të dhënat e Filipoviqit, i cili thotë se kjo festë është më një mars.⁶ Mirëpo, fakti tjetër që jepet nga fshatarët, por edhe nga Filipoviqi është se *Dita e Verës* është festuar nga ortodoksët e dikurshëm dhe myslimanët shqiptarë të këtij fshati, të cilët e kanë llogaritur si festë të përbashkët e që tregon karakterin

⁶ Миленко Филиповиќ, Патишка, Јужни преглед, бр.4, Скопље, 1931, 171.

jofetar të kësaj feste. Me këtë rast Filipoviqi thotë: “Festë e përbashkët për të dy është edhe *Dita e Verës* (në serbishte *Dita e pranverës*, më 1 mars), kur edhe fëmijët serbë edhe shqiptarë shkojnë nëpër shtëpi dhe urojnë ditën e hyrjes në pranverë”.⁷

2. Festën e *Ditës së Verës* e shënojnë fëmijët, të cilët zgjohen herët, ... *vin pi n'gjasht deri m'tet, e hecin katundin, ... deri n'tet e gjym's hecin femia*. Kësaj here, disa fëmijë sikur ishin zgjuar pak më vonë, kështu që pata mundësi t'i regjistroj këta, të cilët me zë të lartë thonë: *Ku i kini kicet e poçet?*, derisa e zonja e shtëpisë u përgjigjet: *Ner verniket, ner çerep!* dhe u dhuron fëmijëve “*koka dhe voe*”, si u thonë këtu sheqerkave dhe vezëve, mirëpo gëzinin më i madh i tyre është kur u dhurojnë vezë. Kjo shprehje gjuhësore në formë të pyetjes: *Ku i kini kicet e poçet?*, gjithashtu mund të llogaritet si relikт gjuhësor, duke marr parasysh se ka mbijetuar deri më sot dhe askush nuk di të sqarojë kuptimin e shprehjes. I vetmi sqarim është ai i Filipoviqit e që lidhet me festën e Pashkëve edhe pse emërtimet “*kicë e poçe*” janë të njohura, *kicë* është “kec” dhe *poçe* është “vorbë”. Filipoviqi thotë: “Këto ditë janë të respektuara edhe te myslimanët. Në të Premten e Madhe në tregun e prodhimeve bujqësore mund të shiheshin vetëm grumbuj të enëve të dheut, të cilat i sillnin poçarët e Draçevës. I sillnin kryesisht për myslimanët, të cilët në të Enjten e Madhe dhe në të Premten e Madhe blinin enë të reja të dheut, që në shtëpi të kenë diçka nga dheu, sepse në të Premten e Madhe është varrosur Krishti”. Po ashtu, ai tregon se janë ngjyrosur vezët; “më parë ngjyrosin tri copë (vezë), të cilat vendoseshin e ruheshin pranë ikonës, e pastaj edhe të tjerat. Të Premten e Madhe asgjë nuk ziejnë”.⁸ Nëse kjo ka ndodhur gjatë Pashkëve, si ka arritur të bartet në Ditën e Verës, është vështirë të sqarohet dhe asnjë nga të intervistuarit nuk

⁷ По аty, 171.

⁸ Миленка С. Филиповић, Обичаји и веровања у Скопској котлини, Српски етнографски зборник, књ. LIV, Живот и обичаји народни, књ. 24, Београд, 1939, 394.

përmend festën e Pashkëve, as në ndonjë datë tjetër. Vezët që i japin fëmijëve janë të paziera dhe të pangjyrosura, por në shtëpi në këtë ditë ziejnë vezë.

Voe ziejn n'shpi n'shpi, si dojn, çeter send s'bojn ...

3. Peri i kuq dhe i bardhë, i cili vihet rreth qafës në Ditën e Verës, nuk mbahet më as nga fëmijët, por fatmirësisht ekziston gjenerata diku rreth moshës 40 vjeçare, që ende e mbajnë kujtimin e këtij peri.

Peçat, na i thomi, penit t'kuq t'vunices, i mbarojn peçat, me dy penja i mbarojn, një t'bardh një t'kuq e bojn bashk dhe i vem do pare e do roza dhe e ven ata sabajle cullve edhe dalin e mbledhin voe, finia pes vjet, gjasht vjet, çatia ja vejn... ma t'mdhenjt s'e ven ... si i ve alltan, një alltan t'vogel një dy roza matan na i mbarojna finis dhe u vinjin n'saba dhe i çonim t'bojn kja poçe, ... per Shyngjergj ata marrin e çojn te lulat dhe e ven te lulat ... pri Dites Veres do e mbajnë e deri n'Shyngjergj ..., ... tradit e moçem ... ne i thomi Shyngjergj ...

Puna e përdredhjes së perit në bosht, duhet të kryhet natën e ditveres nën strehë të shtëpisë. Përdredhja e perit nën strehë të shtëpisë i përket ritualit.⁹ Në perin e përdredhur vihen disa rruaza/roza të verdhë dhe një monedhë e verdhë, lidhet rreth qafës së fëmijës dhe atë e mban deri në Ditën e Shyngjergjit dhe atëherë peri lidhet për ndonjë degë të *kurpinjës* (kulprës), pasi që sillet tri herë rreth saj dhe thuhet: – *Lei t'ligat ktir*, kjo bëhet me idenë për të qenë shëndoshë fëmijët për gjatë tërë vitit.

⁹ Izaïm Murtezani jep sqarim për kuptimin e hapësirave të rrezikshme dhe të palejuara, në të cilën e vendos edhe strehën e shtëpisë. Ai thotë: “Streha e shtëpisë, çdoherë sipas besimit popullor, është areal i preferueshëm për forcat e liga, të cilat ndonjëherë duke ndëjtur mund të shkelen nga pakujdesia e anëtarëve të familjes”. Rite të ciklit antropologjik, Shkup, 2008, 28.

4. *Peçati*, nuk u vihet vetëm fëmijëve, por edhe bagëtive dhe sendeve tjera, si mëtini, duke kryer ritin e tundjes herët në mëngjes me besimin e bereqetit të shtëpisë.

... tundim sabajle mtinin, ... heret n'saba, kur shkojn e mbledhin voet edhe tundin mtinin ... ashtu adeti, ... kur finia lypin vez e te shpia domaçinka tundin mtinin sabah heret ... t'kije bereqet shpija ... edhe mtinit i ven peçat edhe ja marrin peçatin per Shyngjergj dhe ja çojn te lulat atje dhe i marrin gjethet e lulat dhe ja ven mtinit. Tashti nuk shkojn per Shyngjergj.

5. Festimi nis që nga mbrëmja e *Ditës së Verës*, i cili është jo i zakonshëm, e që lidhet sërish me mbrojtjen e bagëtisë, por edhe të bereqetit. Riti kryesor ka të bëjë me krehjen e flokëve dhe lidhet me besimin e ruajtjes së kafshëve të shtëpisë nga kafshët si bolla apo insektet.

Naten e ditveres nuk i krehim fjoket thon se bolla i pi lopet ... nuk i dajn fjoket t'i krehin deri kapercen mbasdrekja athere mundet ... edhe nuk punojn. Vazhdon të sqarojë arsyen e veprimt të këtillë: ... pri sat ditën e ditveres kan izin nder truell kush osht krejt kan izin t'dalin mejdan ... nuk i krehin fjoket ... deri n'drek ditën nuk i krehin se do t'dalin insektet do t'ju pijn... tomlin te lopet deri n'drek nesrit ... as me gjylpon nuk punojn.

6. Këtë ditë amvisja kryen ritualin e pastrimit të shtëpisë, duke e pastruar me fshesë për nëntë herë: *Ditën e Veres ngrihet n'sabajle e mshin odën i fugen bërllloget te uji dhe mbrapa merr vdor dhe e fugin neper oda dhe deri n'drek nont here mshin, qi mos t'hypin morat e pqeshtat.*¹⁰

7. Zbukurimi i shtëpisë me degë thane dhe vendosja e tyre nëpër dyer është rit po ashtu i Ditës së Verës: *N'aksham para se do nisin Dita e*

¹⁰ Hanife Ymeri amvise 1972, intervista e realizuar nga Ibe Mustafa dhe Bukurie Mustafa në maj 2016.

Veres, shkajm e kpusin thōn (thanë – bot.) e ngjijtjūm nga dyert e shpies, thōnet nçelin ma perpara ... edhe e ngjisin te shpija ka dera ...

8. Këtë ditë ekziston besimi se punët e shtëpisë mund të bëhen, por assesi nuk guxon të punojë punë dore me gjilpërë:

Edhe per ditvere punen e dores e nxitojnīm, mos na e lore n'gjym s ndonji send ... edhe punen e dores deri Dita e Veres, si ta nisish para Dite veres, ta sosish, ... s'bon Dita Veres te ta lore n'gjym punin, ... ta kesh t'bitisun, se t' shkan vera gjym s.


9. Atmosfera e festimit përfshinë edhe nuset e reja, të cilat paradite kanë pritur fëmijët dhe pasdite i kanë dërguar te prindërit:

Tjera her kush kishte nuse t're ngrihej me sabah e mveshnin me kakilla, me mveshen ton, i prite finit nusja re te dera ... ju mirte doren e mbrapej i çojn nuset e reja ka nanat e veta, ... nuset e reja i çojn ka fanulja, te nona ... dhurojn vez dhe koka ...

Këtë gjë e ka regjistruar edhe Filipoviqi, i cili thotë: “Shqiptarët që kishin nuse të reja në shtëpi i dhuronin fëmijëve para, ndërsa serbët (mendohet në shqiptarët ortodoksë) nuk jepnin para, por dhuronin sheqere etj.”¹¹, gjë që patishkasitë e mohojnë, duke treguar se gëzimi më i madh i fëmijëve ishte kur u dhurojnë vezë.

Shënimi i kësaj feste është i ngjashëm nëpër rajone të ndryshme, dallimi është në atë që ende e gjejmë të gjallë e të ruajtur. Me kalimin e kohës është më se e sigurt se edhe kjo pak do të humbasë e do të zhdukët përgjithmonë, pa mundësi të rikthimit dhe për të cilën gjë regjistrimet do të flasin në vend të njerëzve, të cilët janë ruajtësit më të mirë të asaj trashëgimie kulturore, për aq sa jetojnë.

¹¹ Филиповић, С. Миленко, Обичаји и веровања у Скопској котлини, Српски етнографски зборник, књ. LIV, Живот и обичаји народни, књ. 24, Српска Краљевска Академија, Београд, 1939, 393.



Fotografi të bëra në Patishkë, në Ditën e Verës, 14 mars 2015

Të dhëna për personat që u intervistuan:

Intervistë e realizuar nga Bukurie Mustafa dhe Ibe Mustafa më 14 mars 2015. Të intervistuar: Rushit Shaqiri— arsimtar në shkollën e fshatit, i lindur më 1964; Kadime Shaqiri amvise, e lindur më 1969, e shoqja e Rushit Sh.; Hanife Ymeri amvise, e lindur më 1972, motra e Kadimes (të gjithë banorë të Patishkës); Qerime Zeqiri, amvise, e lindur më 1958, në Patishkë, banon në Shkup.

BIBLIOGRAFIA:

Филиповиќ, С. Миленко, Патишка, Јужни преглед, бр.4, Скопље, април 1931, 163–174.

Филиповић, С. Миленко, Обичаји и веровања у Скопској котлини, Српски етнографски зборник, књ. LIV, Живот и обичаји народни, књ. 24, Српска Краљевска Академија, Београд, 1939.

Murtezani, Izaim, Rite të ciklit antropologjik, Logos –5, Shkup, 2008.

VEBI BEXHETI

Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë

DITA E VERËS, FESTË MBARËSHQIPTARE ME ORIGJINË PAGANE

Rëndësia e festës dhe porositë e Faik Konicës

Nga shumë festat e motmotit që populli ynë i ka festuar ndër shekuj, Dita e Verës është ndër më të rëndësishmet. Kjo festë, ashtu si edhe ajo e Shën Gjergjit është me vlera të vecanta për Etnologjinë shqiptare, që rrjedh nga lashtësia e arrin deri në ditët e sotme. Është e natyrshme që kjo festë pagane dikur të festohej ndryshe, ndërsa më vonë kjo mënyrë manifestimi të ndryshojë, duke iu përshtatur rrjedhave të kohës, edhe pse vlerat etnokulturore të kësaj feste aq të vjetër e ruajtën elementin identitar të kombit. Ashtu si shumë festa tjera me rrënjë nga periudha shumë të hershme pagane, edhe dita e verës, vit për vit vjen duke u zbehur, si rezultat i shumë faktorëve që karakterizojnë periudha të caktuara historike, pa përjashtuar edhe rethanat e ndryshme religjioze të besimeve monoteiste që festave pagane tentonin tu mveshin edhe ngjyrimet fetare, apo në ndonjëfar mënyre edhe t'i luftonin ato.

Festa e ditës së verës, që sipas Faik Konicës “ është dita në të cilën stërgjyshërit tanë, kur s’kish lindur edhe krishterimi, kremtonin bashkë me romakët dhe grekët e vjetër”, deri vonë, madje në shumë krahina shqiptare festohet edhe sot, pa e humbur karakterin pagan, me theks të vecantë në respektin e perëndive të luleve e të shelgjeve. Meqë shtrirja gjeografike shqiptare ndryshon mjaftë edhe në aspektin e klimës, kjo festë që përqëndrohet në një datë të caktuar, që është 14 Marsi, ndryshon nga krahina në krahinë por pa e lënduar esencën e festës dhe karakterin e saj mitologjik që lidhet me ringjalljen e natyrës dhe fillimin e një jete më të mirë pas mbarimit

të dimrit . Jeta e njeriut shqiptar, madje edhe e kohës ilire aq e lidhur me botën bimore—shtazore kërkonte mbështetje në gjelbërimin e natyrës që sillte pranvera, sepse stina e dimrit e vështirësonte mënyrën e jetesës . Lufta për këtë mbijetesë , si duket, mbaronte në këtë fillim pranvere, edhe pse në disa zona të malësive të hapësirave shqiptare, në këtë kohë ende sundon dimri . Sado që në zona të thella malore, sic është edhe ajo e Malësisë së Sharrit, me 14 Mars natyra mund të jetë ende nën bardhësinë e borës, nuk mungojnë shenjat e para të pranverës . Nëse në këtë periudhë kohore në këto zona të kësaj periudhe kohore vështirë se mund të gjesht lule, plasaritja e fazës fillestare e gjetheve të shëlgut, të thënës dhe të lajthisë mundësojnë që sadopak të mblidhen disa degë për të zbukuruar mjedise të shtëpisë dhe të ambienteve përreth ku rrinin bagëtia . Në vende tjera, sidomos të zonave të Shqipërisë së Mesme e Jugore që i përgjigjen edhe ato hapësira jashtë shtetit shqiptar, kjo festë karakterizohet me mbledhjen e luleve të ndryshme që në këtë periudhë kishte me bollëk.

Për ta kuptuar më mirë rëndësinë dhe historinë e kësaj dite të shenjtë, do thoja, po i referohemi edhe një pjesë tjetër të tekstit të Faik Konicës, me titull “Dita e Verës”, ku thotë: ”Kur shkrin dimri, kur qaset Vera buzëqeshur, e hollë dhe e gjatë si në pikturë të Boticellit, zemra e njeriut shkarkohet nga një barrë, shijon një qetësi, një lumturi të ëmbël. Në këtë gëzim stërgjyshërit tanë ndienin një detyrë t’u falin perëndivet që sjellnin këto të mira “ sot, kjo festë aq e njohur që nga qytetërimi antik ilir, nuk e ka respektin që kishte dikur, nuk festohet në të gjitha zonat, madje, si duket ndonjëherë e lënë anash edhe nga shumë konferenca shkencore që kanë të bëjnë me tema të këtilla, të fushës së etnologjisë dhe etnografisë shqiptare. Falë disa studiuesve, etnologë dhe specialistësh për këto çështje, kjo festë me aq peshë shkencore e etnologjike është e pranishme në studimet e ndryshme, madje edhe në ndonjë konferencë shkencore. Ne jemi të vetëdishëm për mënyrën e jetesës në kohë moderne, globalizimin, kurbetin dhe dobësimin e veprimtari—

ve blegtorale e bujqësore që ishin aq të lidhura me këtë festë por, megjithatë nuk duhet lejuar që të anashkalohet aq lehtë kjo festë e qytetërimit tonë , ndër më të vjetrit e rajonit dhe të evropës . Porosia e Faik Konicës për këtë festë , në esenë që e përmendëm më lartë , edhe sot, pas aq shumë viteve tingëllon bukur . Duke dashur që kjo festë e rëndësishme për shqiptarët dhe historinë aq të lashtë të qytetërimit të tyre, të mbijetojë edhe në të ardhmen, Konica na këshillon : “ Të mos i lëmë të humbasin këto festa të vjetra të racës sonë . Nuk i bëjnë dëm njeriut . Sjellin një gëzim të kulluar në shtëpi . Në një vend ku jeta e të vegjëleve është aq e trishtuar, djelmuria dhe vajzat kanë një rastë të rrallë për të defryer . Për të mëdhejtë , Dita e Verës ka një shije poetike të hollë dhe të rrallë.

Historiku i shkurtër dhe karakteristika e festimit nëpër disa zona

Kjo festë pagane mbarë kombëtare u quajt Dita e Verës sepse me kalendarin diellor /shqiptar dhe të disa popujve të tjerë , llogariteshin vetëm dy stinë të vitit; ajo e verës që fillonte në mars dhe ajo e dimrit që niste me muajin shtator. Sipas kalendarit Julian, Viti i Ri, gjegjësisht, Dita e Verës fillonte me 1 Mars . Ky kalendar u zbatua deri në kohën kur në fuqi hyri kalendar i Gregorian . Këtë ndryshim kalendarik e dëshmon edhe sot emërtimi në gjuhën shqipe i disa muajve që mbajnë emrat e numrave sipas radhitjes,e që fillonin me muajin mars. Me hyrjen në fuqi të kalendarit Grgorian,ky emërtim i disa muajve sipas radhitjes mbeti edhe sot,por tanimë muaji Shtator, Tetor, Nëntor e Dhjetor,nuk indifikohen me emërtimet që vinë nga radhitja e tyre.

Sipas hitorianit Kristo Frashëri,kalendar i vjetër i shqiptarve është edhe më i hershëm se edhe ai Julian i cili u shpall nga Jul Cesari,në vitin 46 para Krishtit.

Dita e Verës konsiderohej si Viti i Ri, me karakteristikat që kishte si:kurbani,buka rituale,zjarret,lidhje dhe qepja e të ligave,ujët e ri që

mbushej pa folur e një sere ritesh tjera që kishin të bënin me fatin dhe pjellorinë e prodhimitarë në mbarë në buqësi,që kishin lidhje me ripërtritjen e ripërtritjen e ringjalljen e natyres në pranverë (shih te Mark Tirta,Mitologjia ndër shqiptarë,Tiranë 2004,f.54).Kjo festë e rëndësishme shënonte shpëtimin nga dimri i ftotë dhe varfëria,që njerëzit e pritnin me padurim sepse atyre bashkë me bagëtinë u jepte jetë,kur ishin në luftë për mbijetesë.Kjo e mirë,vera pra,sillte gëzim përtëritje,shpëtim nga të këqiat e dimrit.Një thënje popullore ndër shqiptarë të rajonit të Tetovës thotë:”Ni here vajn vera ka dera”. Të këtilla shprehje që e freskojnë verën ka mjaftë sepse në të shihet shpëtimi, shëndeti e gëzimi.Vera në disa raste është edhe sinonim i buzëqeshjes . Për njeriun e zymtë e të mrolur shpesh herë thuhej :” Verë me gjoj nauk boni”,thuhet në fshatin Veshallë të Tetovës.Kjo festë me emërtimin Dita e Verës është festuar deri vonë në tërë trojet shqiptare.Sot kjo ditë sikur është nën hijen e manifestimit qendror të Elbasanit dhe Ballokumeve të njohura të këtij qyteti.Elbasani,si vendbanim shumë i lashtë shqiptar e meriton epitetin e kryeqendrës së Ditës së Verës sepse e ruajti me xhelozi dhe e festoj në kontinuitet,nga lashtësia, e deri më sot .Me gjithë karakterin aq masiv të kësaj feste në Elbasan,manifestimi i kësaj natyre sikur e ka humbur karakterin e një feste pagane me elemente mitologjike.Kjo festë,tani më e shpallur si ditë jopune,edhe pse e vazhdon traditën,po mer fizionomi të një manifestimi urban duke u zhveshur vazhdimisht nga elemente të vjetra,me peshë të madhe për etno kulturën tone.

Dallime më të vogla në mënyrën e festimit të kësaj dite ekzistojnë nga krahina në krahinë,porgjithsesi dallimet më të mëdha vërehen nga veriu në jug.Nga disa zona është karakteristikë ndezja e zjarreve,traditë kjo shumë e vjetër pagane që ka përqëlím t’i ndihmojë diellit .Po thuaj në të gjitha rajonet e hapësirës shqiptare për këtë festë,karakteristike janë “Veroret” ose siç quhen në disa katunde të Malësisë së Sharrit” Pejti e Thanës.Në studimet e gjertanishme të fushës së Etnologjisë,ende nuk janë përfshirë të gjitha zonat e

shtrirjes së hartës shqiptare,që lë përshtypjen sikur kjo festë as që ka ekzistuar ndonjë here.

Si festohet Dita e Verës në fshatin Veshallë dhe Bozofcë të Malësisë së Tetovës

Sipas karakterit dhe lidhjes së kësaj feste me natyrën, ringjalljen, përtëritjen e jetës,botën bimore e shtazore dhe praninë e elementit mitologjik, Dita e Verës deri vonë është festuar edhe në zonën e Tetovës, Gostivarit, Kërçovës, Strugës dhe disa vende tjera të banuara me shqiptarë. Viteve të fundit,të mos themi edhe dekadave të fundit, kjo festë vjen duke u zbehur vazhdimisht.Në disa fshatra të Malësisë së Sharrit, mbi Tetovë, për fat të mirë kjo traditë,edhe pse jo me intesitet të plotë, festohet edhe sot, ashtu si edhe festa e Shën Gjergjit me Ditën e Luleve dhe disa festa tjera, siç është edhe ajo e Karnivaleve Ilire që festohet në fshatin Bozofcë, falë përpjekjeve të profesorit të ndjerë Fadil Sulejmanit,për ripërtirjen e këtyre festave me vlera aq të mëdha etnokulturore. Në fshatin Veshallë,Dita e Verës festohet me ceremoni të ndryshme me karakter mitologjik, përmes riteve të ndryshme. Ajo që është karakteristikë e përbashkët edhe e vendbanimeve tjera të kësaj zone është mbështetja në stinën e re respekti për natyrën sapo të liruar nga bora,edhe pse në këtë datë,siç e theksuam edhe më pare, shpeshherë dimri është i pranishëm me tërë acarin e vet. Penjtë e Thanës (Pijte e Thonës) që patjetër përbëheshin nga dredhja e një peri të bardhë dhe një të kuqi që e formonin spiralen bardh e kuq, nënat ua venin fëmijëve në qafë dhe në duar, ishin elementi kryesor që simbolizonte dëshirën për shëndet të plotë. Këto penj mbaheshin plotë një javë,deri në mëngjesin e Ditës së Verës, kurë me ceremoni festive përcilleshin jashta fshatit për t'i varur në ndonjë degë thëne, pemë kjo që çelë e para në këtë fillim pranvere. Vajzat me këngë e valle, të përcjella me def (dahire), të veshura me teshat më të mira që i kishin,pasi i varshin penjtë,tanimë në formë tufe,në degë thëne,mblidhnin nga ato pak gjelbrime që mund t'i gjenin, si :lule thëne,sytha të shel-

gut,të emërtuara si maca dhe ato të lejthisë të emërtuara si dash e dele dhe ktheheshin sërish duke kënduar.Me këtë rast e falëmdë-rojnë vajzën nga fshati Veshallë,Bukurie Ramizin për këngët që na i ofroi,për tu bërë pjesë e këtij studimi.Ashtu si në Ditën e Luleve edhe në këtë rastë,bashkë me grupin e vajzave të lagjes kishte edhe djem,të familjes ose mëhallë,që duhej të kujdesëshin për to,për të cilët këndoheshin këngë:*do shkojmë për dit vere/napër ara/, me Valon agën përpara*.Përmes vagjeve të ndryshme që i këndojnë kësaj dite të bekuar, dyshja e vajzave për disponimin e një atmosfere gëzimi që na falë kjo festë,i këndojnë edhe vargjet:*Ditë Vere sa e majra kone/kit të rive qefin va bona*.Tërë këtë ceremoni të përcjellë me këngë, të rinjët e të rejtat e çdo mëhale që niseshin në drejtime të ndryshme,varësisht se në ç'vend gjendej thëna,diku jashta katundit,e përshkuranin me vargjet: *Shkuëm për Dit Vere/Bom pak potere/Dit Vere sa e majra kona/kofsh për ditën tone*. Gëzimin për këtë ditë që jep jetë e gjallëri e që e paralajmëron se do të vijnë ditë më të mira për jetë normale,kur me bagëtitë do dilet në stane, për të vazhduar jetën verore jashta fshatit në bejshkët përreth, këngëtari popullor i thuri këngë edhe kësaj mënyre të jetës bashkë me bagëtinë,edhe pse data 14 Mars,dita e kësaj feste është ende shumë larg nga koha kur mund të dilet në stan. Sidoqoftë, vargjet që këndohen në këtë rast paralajmërojnë edhe kohën kur nga këto anë do të shkrihet edhe bora e fundit.Ja çka thonë vargjet e kësaj kënge:*Mori lum e lum na duel vera/do t'i çelim stonet dera dera/ani dera dera gjith ukolla/do voje heshëm si rremi me molla/ani dera dera me kotara/do voje heshëm, si rremi me dardha/*. Me që tërë e kjo ceremoni festive bëhet me rastin e dërgimin të Penjve të Thanës me tërë të ligat,vargjet në vazhdim e përshkruajnë edhe këtë moment: *I çojm pitë e thonës/t'lomë t'ligat e nonës/Dit Vere sa e maejra kone/kofsh për ditën tonë*.

Penjtë e Thanës që janë në kombinim të ngjyrave bardh e kuq vetëm fëmijët i mbajnë në qafë e duar deri në ditën kur do t'i dorëgojnë te ndonjë Thënë,ndërsa atë ditë përgatiten penj edhe për të

gjitha anëtarët e rritur të familjes, që bashkë me atë të fëmijëve që i kanë bartur në qafë dhe duar, i dërgojnë atje ku e kanë vendin. Djemtë dhe vajzat e reja, pasi i lënë tufat me penj për të gjithë anëtarët e familjes, nuk kthehen duar thatë por bashkë me ato degë të drunjve që i përmendëm më parë, mbushin enë me uij lumi ose të ndonjë përoi që gjendet aty afër, që quhet Uji i Ri, me të cilin, sapo të arrinë në shtëpi, pa e lëshuar enën në tokë, i stërpikin bagëtitë për të qenë më të shëndoshë dhe për tu ruajtur nga shpirtat e këqinj. Ashtu si në Malësinë e Veriut të shqipërisë, edhe në këto anë gjetëm gjurmë të penjve të zi që po ashtu varen në ndonjë degë peme për t'i luftuar të gjitha të këqiat që mund t'i bëjnë botës bimore e shtazore, madje edhe kafshët e egra zullumqare që mund të dëmtojnë bereqetin këtë rit e hasëm në fshatin Bozofcë. Në Veshallë kjo luftë kundër dëmtuesve të të lashtave buqësore, si duket, është bërë në të njëjtën mënyrë, por tani për tani i ramë në gjurmë një mënyre tjetër të luftës kundër shtrigave dhe dëmtuesve tjerë, kafshëve të egra.

Gatimet speciale për Ditën e Verës, në këta dy fshatra më karakteristike janë merendja (Veshallë) dhe flija (Bozofcë) dhe zierja e kokrave të misrit. Në Veshallë, para se të shtrohet merendja në sofër, një pjesë e ndarë lihet në murallin e lëmës, ku shumë lehtë mund të vij lepur i zullumqar për ta ngrënë atë. Me këtë rast, ai që e dërgon copën e merendes në lëmë, i drejtohet lepurit me këto fjalë: *lepër, lepër/mo na e ha gjrunin/se do ta thi gjunin/lepër lepër/mo na e ha tërshonën/se do ta thi komën/lepër lepër/mo na e ha theknin/se do ta thi skepin*. Për këtë rit, dhe për shumë adete tjera, që kanë të bëjnë me Ditën e Verës e falënderojmë Shahine Bexhetin, me moshë 92 vjeçe (nëna ime), që me aq përkushtim dhe kujtesë të freskët na ndihmoi që ky punim të dalë sa më original. Gjithmonë sipas saj në një periudh kohore të caktuar deri në Ditën e Verës, ndalohej edhe qepja ose arrnimi me gilpërë, sepse kafshët që milen mund ta shterrnin tamblin me që gjatë kullotjes mund t'u shpohen gjinjtë. Ky gatim tradicional, merendja ose flija, në fshatin

Bozofcë,përveç si ushqim,kishte edhe një rëndësi të veçantë për ritin e ndarjes së punës,brenda anëtarëve të familjes, gjatë ditëve të verës.Me që merendja gatuhet me qullë të hollë,rende rende,gjatë pjekjes me saç,në njërin nga rendet futen disa elemente që simboli-zojnë veprimtarinë buqësore e blegtorale,që mundë të jenë imitim nga druri,në miniaturre,si psh.Soha e stanit (njërat nga shtyllat që e mban kulmin e këtij objekti), zgjedha e pllugut ose ndonjë pjesë tjetër.Këto elemente të vogla druri që indentifikohen me veprimtari të ndryshme, të punës për verën që vjen ndonjëherë zëvendësohen edhe me produkte të ndryshme nga këto veprimtari,siç janë llojet e bulmeteve ose të drithërave,përmes pjesëve të vogla të kallinjve të grurit,elbit ose thekrit.Këto rite që bëhen sipas rregullave tradicionale etnologjike,si pjesë e gatimit kryesorë me rastin e festës së Ditës së Verës që i zbuluam në këto dy fshatra,janë të një rëndësie të veçantë,për sa i përket organizimit të punës gjatë verës dhe caktimit të detyrave të anëtarëve të aftë për punë të familjes. Që t'u iket mos marveshjeve mes anëtarëve të familjes,ose refuzimit të punës që mund ta bëjnë gjatë verës,mënyra e caktimit të punës,përmes gjetjes rastësore të këtyre që fshihen në njërin nga shtresat e merendes, është më objektive që nuk lë vend për manipulime se kush çfarë pune duhej të kryhet. Nëse në kafshatë qëllon simboli i buqësisë dihet cila do jetë veprimtaria e antarit të familjes,ashtu siç dikë fati e drejton në veprimtarinë blegtorale, apo edhe në ndonjë punë tjetër.

Këto ishin disa nga karakteristikat dhe mënyën e festimit të Ditës së Verës të fshatit Veshallë dhe Bozofcë të Malësisë së Sharrit të Tetovës. Kur i kemi parasysh edhe fshatrat tjerë të kësaj zone, të banuar vetëm me popullatë shqiptare, e që jetojnë në të njëjtat kushte,me siguri këto rite dhe mënyra e festimit të kësaj feste mundë të jenë indentike ose të ngjashme me këto që i përmendëm .Shkencën e etnologjisë shqiptare,me gjithë rezultatet e ariutura në shumë zona, e pret edhe shumë punë për ti lëvruar të gjitha hapësirat shqiptare,që ta ndriçojë sa më shumë këtë festë pagane që vjen nga lashtësia e që është ruajtur me aqë lashtësi e që të ari deri

në ditët tona.Kjo festë është e të gjithë shqiptarëve,pavarësisht përkatësisë rajonale, dialektore, klasore, fetare e ideologjike,që rrjedh nga lashtësia Ilire.

PROF. DR. HAMIT XHAFERI

Universiteti i Evropës Juglindore – Tetovë, Maqedoni

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit

SIMBOLIKA E DITËS SË VERËS NË TREVËN E KËRÇOVËS

Kërçova është njëra ndër zonat shqiptare në Maqedoni në të cilat më së shumti është kremtuar gjatë Ditës së Verës. Sofra kërçovare është karakterizuar me begatinë e saj në këtë ditë me shumë festime dhe gazmende të lamishme. Këtë manifestim veror të mbushur me plot gëzime, kohëve të fundit e ka hapur grupi "Uskana" me ekzekutimin e "himnit kërçovar". Më pas dalin në skenë edhe grupet me këngëtarë kërçovarë, duke interpretuar për të pranishmit këngë e valle popullore. Grupi kërçovar i vallëtarëve, të vajzave dhe djemëve paraqitet me disa valle të bukura me motive të kësaj treve, që e bëjnë edhe më të hareshme ditën dhe mbrëmjen festive të Ditës së Verës. Është karakteristik libreti i mbrëmjes festive të Ditës së Verës i përgatitur me shumë mjeshtëri, duke përshkruar dëshirën dhe entuziazmin që kanë patur kërçovarët, për ta bërë Uskanën në Ditën e Verës si dikur në lashtësinë Ilire.

Në këtë trevë kjo ditë pasqyron simbolikën e dikurshme në të cilën stërgjyshërit tanë, kanë kremtuar bashkë perëndit' e luleve, të shelgjeve dhe të krojeve. Në këtë trevë ndeshim kulte pagane të besimit në ujëra të shenjtëruar, në gurë, në drunj, në shpella e tjerë. Tipike për këtë ditë kanë qenë edhe frekuentimet e "vendeve të mira", të njohura për efektet shëruese dhe fatsjellëse, siç është vendi i mirë që gjendet në mes të Zajazit dhe Greshnicës i quajtur "Ujt' e veshëve". Besohet se larja me ujin e këtij vendi, sidomos në Ditën e Verës ka sjellë pjellorinë dhe fatin e mirë për gratë dhe shëndet për fëmijët. Ndërsa në vendin e quajtur "Markuli" të zonës së

Oslomejit gjenden disa kroje si "Ujti Xhumas", "Ujti Mëkurës" dhe "Ujti Mortes", në të cilët gratë shkojnë për të gjetur ilaçin e shërimit. Gjithashtu një kult të vjetër fetar të lutjeve për shërimin e grave e ndeshim në fshatin Sop të Kërçovës që i takon vitit 1476. Popullata i është gëzuar ikjes së dimërit të ftohtë dhe ardhjes së Verës të buzëqeshur, të hollë e të gjatë si në pikturë, ngase zemra e shqiptarve të kësaj treve sikur shkarkohet nga një barrë, për të shijuar në këtë ditë një qetësi dhe lumturi të ëmbël. Kjo ditë për njeriun shqiptar të kësaj treve, në kuadër të dokeve, riteve e krijimeve të ndryshme shpirtërore ka të bëjë me ringjalljen pranverore të natyrës në raport me dimrin që jep shpirt apo është duke shkuar. Këtë gëzim, të parët e kësaj treve e kanë ndjerë, madje në të gjitha format e shprehjes, përmes këngës, lojës, veshjes, ushqimit, frikës, bestytive, lutjeve si një detyrim i veçantë për perënditë që kanë sjellur gjithë këto mirësira. Në fshatin Garanë ekziston një tip shtëpie e ndërtuar në shek. XV, që ka shërbyer gjithashtu si kult i besimit dhe lutjeve fetare. Kësisoj ka lindur festa e bekuar të cilën kërçovarët e kanë quajtur "Dit'e Verës" e cila në të vërtetë, në popullatën e këtushme njihet me konceptin: "gjashtë muj' verë e gjashtë muj' dimën!". Me kalimin e kohës shënimi i kësaj dite në këtë trevë duket se po zbehet. Por ç'duhet bërë që kërçovarët këtë festë të vjetër tradicionale të tyre të mos e humbasin, kur e dimë fare mirë se kjo festë e vjetër e trashëguar brez pas brezi nuk i ka bërë dëm njeriut shqiptar, përkundrazi kërçovarëve u ka sjellur ndër shekuj vetëm gëzime në gjirin e tyre familjar. Në një trevë si kjo e Kërçovës ku jeta e të rinjve dhe të rejave ka qenë sa e bukur aq dhe e trishtë, ku djemtë dhe vajzat apo siç i quajnë kërçovarët (gocat dhe cucat) kanë një rast të rallë për tu dëfryer dhe kënaqur në këtë ditë të shenjt për ta, prandaj kjo festë rëndom njihet si festë e vajzave. Kurse për më të rriturit, Dita e Verës ka një shije pak sa ndryshe, duke marrë një kuptim poetik të hollë e të rrallë. Kjo moshë me përkushtim të veçantë e feston Ditën e Verës, duke i ruajtur me xhelozi dhe përkushtim traditat e hershme kërçovare. Megjithatë kohëve të fundit, Dita e Verës, si

një prej festave të lashta pagane ka filluar të kremtohet gjithnjë e më pak edhe në këtë trevë. Për fat të keq, kjo traditë vjen duke u zbehur nga viti në vit dhe nga gjenerata në gjeneratë. Festohet gjithnjë e më pak, dhe kështu tradita e shënimit të kësaj feste si dikur vjen duke u humbur dhe harruar. Njëra prej arsyeve është se njerëzit e kësaj treve duke u lidhur gjithnjë e më shumë me besimin fetar islam, sikur u largohen festave pagane, me arsyetimin se nuk janë fetare. Më të moshuarit, pleqtë e plakat evokojnë me nostalgji kujtimet e tyre sesi e kanë festuar Ditën e Verës dikurë, e cila duket fare qartë se kjo traditë e bukur është ngulitur thellë në shpirtin dhe zemrën e tyre që në fëmijëri. Ajo që na bie në sy kohëve të fundit është për të ardhur keq kur vërejmë sesi po na vidhet nga të tjerët Kultura dhe Tradita jonë dhe atë para syve dhe veshëve tanë në pikë të ditës. Me këtë do të thoshim se kjo kulturë dhe traditë e vjetër e kësaj feste popullore, shpirtërore shqiptare me origjinë të lashtë pagane është vënë në rrezik, na duket se vajton me gra Zajazi duke kërkur nga qenia shqiptare ndihmë dhe mbrojtje. Kur dihet mirëfilli se kjo është festë e lashtë arbëreshe, e trashëguar në veçanti nga qytetarët e Skampës së lashtë që festohet edhe sot e gjithë ditën në çdo 14 mars. Ky manifestim kryhet në nderim të natyrës së bukur të ambientit shqiptar dhe bimësisë që ka marrë jetë ndër shekuj mu në këtë datë.

Dikur pikniqet familjare në natyrë kanë qenë një prej aktiviteteve më popullore në këtë trevë, qëllimi i preferuar ka qenë Kalaja e Kërçovës. Shenja dalluese të këtij festimi gjithpopullor kanë qenë gatimi i magjatoreve, të cilave nuk i shmangen as gratë, veçanërisht nuset, si ndihmëse gatesash të "kuleçëve gjish e piçë", "burekut me groshë", zierja e "kokrrave të misrit në hi" dhe ëmbëlsirave nga më të ndryshmet, por ëmbëlsira më e njohur në këto treva ka qenë e ashtuquajtura "jallanka". Ndërsa gratë më të vjetra, si dhe amviset, janë shquar si zonjat e bulmetrave. Kurse burrat dhe djemtë e rinjë, më shumë janë hisetarë në të ngrënë e në të pirë, sesa për të

ndihmuar, përveç në sigurimin e druve apo ndonjë veprim që u shkon atyre më për natyre.

Ndonëse kjo ditë vazhdon të ruhet dhe festohet deridiku në qytetin e lashtë të Kërçovës, duke u konsideruar si festë e të gjithë shqiptarëve. Sot kjo festë popullore në këtë trevë ka një simbolikë festive popullore të ndjeshme. Më 13 mars në disa raste gratë së bashku me vashat e reja marrin tufa lulesh prej shelgjeve apo degë të vogëla lulesh me rrënjët dhe dheun, që ta kenë në shtëpinë e tyre në mëngjesin e datës 14 mars. Ky zakon i lashtë dikurë i ruajtur me fanatizëm dhe festuar në fshatrat e anës së Zajazit dhe ato që gravitojnë në anën e Oslomejit vjen gjithnjë duke u zbehur.

Kjo ditë është konsideruar si dita e fillimit të vitit sipas kalendarit shumë të lashtë të shqiptarëve, pra një ditë që është kremtuar shumë shekuj para se të lindëte krishterimi. Dikurë, Dita e Verës është kremtuar në këtë trevë më 1 mars të kalendarit Julian, e cila ka simbolizuar ditën e parë të vitit të ri, ndërsa sipas kalendarit Gregorian, më 14 mars, si dita e fillimit të verës. Kësisoj është shndërruar në një festë të gjithmbarshme të banorëve të fshatrave të kësaj treve, sidomos të rinjëve dhe të rejave, duke marrë kuptimin mbarëshqiptar, që është kremtuar anë e kand me nuanca të ndryshme, sipas vendbanimeve të këtyre fshatrave dhe traditave, dokeve dhe zakoneve të tyre. Si dëshmi po sjellin këtu dy përshkrime të kuptimit dhe kremtimit të "Ditës së Verës" njëra për fshatrat e anës së Zajazit, tjetra për fshatrat e Oslomejit apo siç i quan populli ana e rretheve, madje në kohën kur institucioni klerikal islam nuk kishte ndërhyrë akoma në kremtimet e ashtuquajtura pagane, por vetëm disa veprime rreth festës së Verës i quante "bedate".

Dikurë gjatë Ditës së Verës stërgjyshët tanë nga kjo trevë, kanë kremtuar së bashku perënditë e luleve dhe të shlegjeve. Këta i janë gëzuar shkrirjes së borës dimërore, veçanërisht kur qaset vera e buzëqeshur, e hollë dhe e gjatë me një panje piktoreske të "Ligatës", është ky një topos që gjendet në fshatin Zajaz, ku dikurë

zenra e njerëzve të kësaj treve është dukur sikur shkarkohej nga një barrë, duke shijuar një qetësi dhe lumturi të ëmbël. Në këtë gëzim, dikurë të parët tanë e kanë ndjerë si detyrë t'u falen dhe lutën perëndive që sjellin këto mirësira. Duket se në këtë mënyrë ka lindur kjo festë e bukur dhe e bekuar që e kanë quajtur Dita e Verës. Në pakë ditë në fshatrat e Zajazit dhe Osllomejtit që gjenden buzë maleve, dikurë besnikët e fundmë të paganizmit, pa dashur dhe pa ditur, i kanë rrethuar me verore degët e thanave, dëllinjave dhe shelgjeve. Këta si zakonisht kanë këputur degë të gjelbërta duke i vënë në hyrje të dyerve dhe shtëpive. Sot jemi dëshmitar të zbehjes gjithnjë e më shumë të kësaj feste ku është për të ardhur keq që i lëmë në blozën e harresës të humbasin këto festa të vjetra të racës sonë. Kur dihet mirëfilli se kjo festë e bukur popullore nuk i bën aspak dëm njeriut shqiptar, përkundrazi i sjell një gëzim të bukur e të kulluar në shtëpitë e tyre. Sot kur jeta e të vegjëleve në këto vendbanime rurale është më e vështirë, e mërziqshme, djemtë dhe vajzat kanë një rast të rrallë për tu dëfryer. Për të rriturit, Dita e Verës ka një shije dhe kuptim tjetër lirizmi ndjenjash të holla e të rralla poetike.

Kohë më parë, plakat e kësaj treve kanë bërë rite magjike kundër qenieve dëmtuese dhe grabitëse. Këta dy—tri ditë para Ditës së Verës i kanë fshehur shoshat, sitat dhe furkat me shtëllunga leshi që mos t'i shohë asnjë pjesëtar i shtëpisë, sepse për ndryshe nuk mund të lidhej gjë për ndonjë dëshirë. Djemtë shkonin në mal për t'i kullotur kafshët, afroheshin pranë lisave dhe e mbështetnin shpinën e tyre tek lisi duke e fërkuar shpinën e tyre thonin: "si lisi ç'i asht i fort' ene aun të jeshja i fort'". Kjo të lë për të kuptuar edhe një shprehje tjetër interesante: "mjedisi si lisi, lisi si mjedisi". Një lis i këtyllë të cilin populli e quan "Lisi me birë" që gjendet në Çukën e fshatit Cërvicë, është një fenomen që ka krijuar natyra ku shqiptartët fallen, duke e konsideruar si objekt kulti prej mijëra vjetësh, që atyre t'u lindin fëmijë dhe të rrojnë gjatë (Murati Qemal, Kërçova në traditat e saj të vjetra).

Në Ditën e Verës, pjesëtarët tjerë të familjes pas darke janë bashkuar rreth zjarrit, duke biseduar e herë pas here duke kënduar apo rrëfyer ndonjë përrallë e mesele. Festimet e kësaj dite janë përgatitur ditë më parë. Djemtë e rinj fillimisht kanë vajtur në mal dhe kanë prerë dëllinja, degë lisi e tjerë, të cilat i kanë sjellur në fshat dhe i kanë vendosur në formë të mullarit. Këta mullarë janë ngritur kryesisht në mes të fshatit apo lagjes, në mënyrë që zjarri të jetë sa më i dukshëm për fshatarët. Kur errej dita, dhe zëvendësohej nga hëna, të rinjtë janë afruar rreth mullarëve të dëllinjave, duke pritur çastin që t'i vënë zjarrin i cili sapo ndizej. Me këtë rast djemtë kanë gjuajtur me guralecë nga një distancë relativisht e largët, për të larguar dhe vrarë të keqen, në mënyrë që pranvera të jetë më reshje të bollshme, për të siguruar të korra të mira me shumë "bereqet", nga të cilat do të krijoheshin rezerva të bollshme për të kaluar periudhën e gjatë të dimrit. Ndërsa vajzat dhe djemtë e zonës së Oslomejit vënin rreth qafës dhe duarve një perë të përdredhur të kuq dhe të bardhë të quajtur "smilkesha" dhe këndonin këngë të ndryshme që i dedikohen Ditës së Verës (Osman Adili, teknik dhëmbësh nga f. Haranjell i Kërçovës). Po kështu vepronin djemtë, vajzat dhe fëmijët e anës së Zajazit, të cilët perin përdredhur të kuq dhe të bardhë me një para prej metali të shpuar, të quajtur "tos" e vënin rreth qafe dhe në dorë. Këta stoli i mbanin gjer në ditën e Shëngjergjit, ku po këtë ditë i nnxjerrnin nga qafa dhe duart dhe i varnin në degët e mollës, duke thënë me zë: "si molla qi lulzon ene ne të lulzojm", apo: "si molla qi lulzon ene fëmija të lulzoj". Zgjimi bëhej në të gdhirë dhe të moshuarit herët në mëngjes hapnin derën e shtëpisë për bujari, merrnin shtamën për ta mbushur me ujë të freskët dhe sillnin në shtëpi një krah me bar të gjelbëruar. Gratë plaka zgjohen herët në mëngjes për të mbledhur thupra thane dhe lajthije dhe shkojnë njeri më njeri, pa dallim gjinie u sjellin me thupër thane ose lajthie pas shpine dhe rreth vitheve, duke u thënë: "si lejthëja ç'i asht' e lenë ene tëi të jesh' e lenë". Pra, në mëngjes është vendosur një garë e pashpallur se kush do zgjohej më shpejt (sipas traditës ai që zgjohej më vonë do t'i shkoj i gjithë viti në të

shumtën e kohës në gjumë). Familjet që janë zgjuar më vonë, si zakonisht kanë patur edhe një ndëshkim simbolik, duke iu mbyllur nga jashtë dera e shtëpisë. Pasi janë zgjuar, të rinjtë kanë dalë për të mbledhur lule si kukureka, lulethane, shëlgje etj, të cilat i vënë mbi portën hyrëse dhe brenda shtëpisë. Ndërsa vajzat ziejnë vezë dhe i ngjyrosin me ngjyrë qepe të kuqe. Vezët thyhen mes të rinjve dhe të rejave (që do të thotë se ai apo ajo që e ka pasur vezën më të fortë ia merr atij apo asaj që i thyhet). Këto ngjarje kanë ndodhur si zakonisht në një livadh ose në qendër të fshatit, ku përvec këtyre riteve janë bërë edhe mjaft lorja të tjera si: "kërcim me shkop", mundje mes djemve të rinj e tjerë.

Menyja e festës ka patur gatesën tradicionale në zonën e Kërçovës, specialiteti prej brumi të pjekur në saç, siç ka qenë "sylpytja" dhe disa lloje ëmbëlsirash, veçanërisht e ashtuquajtura "jallanka". Gjatë paraditës nënat kanë përgatitur drekën e bollshme dhe të begatë, ku një vend të veçantë ka zënë "laknuri" dhe e ashtuquajtura "petlla xheline" të cilat janë kryesisht (gatime tradicionale të zonës së Kërçovës). Pas ngrënies së drekës, djemtë dhe vashat kanë dalur për vizita tek të afërmit. Kështu është mbyllur festimi i Ditës së Verës, si një festë që ka sjellur vetëm gëzim, harmoni dhe lumturi në familjet e kësaj treve. Kjo tregon se shqiptarët e trevës së Kërçovës e kanë ruajtur dhe kultivuar brez pas brezi identitetin e tyre kombëtar. Dita e Verës e vërteton këtë lidhje të shqiptarëve të këtushëm, sepse është ruajtur me shumë fanatizëm deri në ditët tona. Natyrisht që nga fillimet e krenimit të saj deri sot, kohët kanë ndryshuar dhe për rrjedhojë edhe mënyra e festimit, por forma bazë e saj është poaq e përafërt, duke mbetur një festë me origjinë dhe traditë shqiptare që i dedikohet stinës së pranverës, me të cilën rigjallërohet gjithçka pas një gjumi të lodhur dhe të gjatë dimëror. Sot, Dita e Verës nga kërçovarët konsiderohet si ditë e festës së lashtë e shqiptarëve, kur këta orientoheshin në diellin, hënën dhe gjelbërimin, që shënon fundin e dimrit të acartë, hyrjen e pranverës dhe çeljen e luleve. Kjo është festë mbarëpopullore e te gjithëve, e

të pasurve, e të varfërve ku të gjithë gëzojnë. Me këtë rast duhet të themi qartë se as feja, as ideologjia dhe së fundi as politika, nuk mund ta kenë si të tyre këtë festë.

Shpeshherë ia parashtrojmë vetvetes pyetjen pse kjo ditë quhet e Verës? Përgjigjja lidhur me këtë na del vetvetiu, për arsye se kjo ndodh kështu në kalendarin diellor ilir/shqiptar, në të cilin ka vetëm dy stinë, Verë dhe Dimër, dhe stinët nisin me barasnetët në mars e shtator duke arritur mesin me solsticet në qershor e dhjetor, atëherë kur festohet, përkatësisht Mesvera dhe Mesdimri. Më së miri arriti ta shpjegojë shpirtin e Ditës së Verës, shkrimtari ynë i ndjenjës Faik Konica. Ai e përkufizon kështu këtë festë: "Dita e Verës është dita në të cilën stërgjyshërit tanë, kremtonin bashkë perënditë e luleve dhe të shelgjeve. Kur shkrin dimri, kur qasej vera e buzëqeshur, duket se zemra e njeriut po shkarkohej nga një barrë, duke shijuar një qetësi dhe lumturi të ëmbël. Në këtë gëzim me siguri kanë ndjerë një synim që tu faleshin perëndive të cilat kanë sjellur mirësiara.

Literatura dhe informatorët:

Intervista me vajza dhe gra, pleqë e plaka nga treva e Kërçovës, të zonës së Zajazit dhe Oslomejit.

Informatori Osman Adili, teknik dhëmbësh, fshati Haranjell, Kërçovë

Mehdiu Feti, Nga Kërçova për Kërçovën, Kërçovë, 1995

Murati Qemal, Kërçova në traditat e saj të vjetra, Shkup, 1996

Shala, Demush: "Letërsia Popullore", Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK, Prishtinë, 1983.

Shala, Demush & Zajmi, Abdullah: "Leximi letrar", ETMM i KSAK, Prishtinë, 1972

Uçi, Alfred: "Probleme të estetikës", RB Rilindja, Prishtinë, 1980.

Xhaferi Hamit, Epika popullore shqiptare e trevës së Kërçovës, Arbëria—design, Tetovë, 1996.

PROF.DR. MUSTAFA IBRAHIMI

UEJL, Tetovë

DITA E VERËS NË TREVËN E PELAGONISË

Hyrje

Ndryshimi i dukurive në natyrë, si kursi i diellit, fazat e hënës, këmbimet pranverë, verë, vjeshtë, dimër, ditë, natë kanë krijuar mite, besime e rite karakteristike. Një cikël i tillë ritesh popullore fillon gjatë marsit, i njohur edhe si **cikli i festave të pranverës**, i cili bie më **1 mars** – sipas kalendarit të vjetër ose më 14 mars – sipas kalendarit të ri, festohet në të njëjtën ditë si te shqiptarët dhe maqedonasit [Penushliski 1973:11], ashtu edhe te popujt e tjerë të Ballkanit e më gjerë [MF 1973:11–202]. Në disa krahina, sipas kushteve festohej edhe më vonë si p.sh. në *Gjriokastër*, ku Dita e verës festohej më 1 maj, kurse në fshatrat e Kumanovës sot e kanë bartur në Shëngjergj. Pikërisht me këtë datë është e lidhur një nga ritet më tipike dhe më të përhapur te popujt e Ballkanit, si te krishterët ashtu edhe te myslimanët, pritja e një marsit dhe mbajtja e veroreve. Me këtë festë janë praktikuar dhe ende praktikohen rituale të vjetra të lidhura më një marsin, që i kanë rrënjat që në kohërat e lashta.

Këto zakone të vjetra me verore rreth dorës, i mbajnë mend vetëm gjyshet, të cilat brez pas brezi i kanë trashëguar nga stërgjyshërit të cilët ende kur s’kishte lindur krishterimi, kremtonin bashkë me romakët dhe me grekët e vjetër perënditë e luleve, të shelgjeve të zogjve shtegtarë etj. Ata paralajmëronin shkrijen e borës, dhe buzëqeshjen e verës, kur zenra e njeriut shkarkohet nga një barrë, shijon një qetësi, një lumturi të ëmbël. Në këtë gëzim, stërgjyshërit tanë ndienin një detyrë t’u falen perëndive që sillnin këto mirësia. Kështu lindi festa që e quajmë Ditë e Verës.

Sot verorja është para se gjithash traditë dhe një urim simbolik për shëndet dhe fat të mirë. Por dikur veroren e kanë konsideruar si amulet i cili mbron njerëzit, bagëtinë dhe shtëpinë nga “fuqitë e këqija” të dimrit.

1. Tradita e përdorimit të veroreve (martinkave)

Disa rite lidhur me ciklin e festave të Pranverës janë ruajtur në shumë krahina shqiptare, kurse ne do të fokusohemi në trevat shqiptare të Pelagonisë, Edhe, muajin mars e presin të stolisur me verore që janë bërë nga një fije e thjeshtë prej penjsh të bardhë dhe të kuqë – kjo është “verorja klasike” që në festat pranverore u vihej të vegjëleve "për shëndet" . Nëpër treva të ndryshme veroret janë emërtuar me emra të ndryshme si: *marse*, *verore*, *guduvere*, *kosa*, *larse*, *veroskë* (Kranjë–Prespë), *laramane* (Podgur), *martinka* në rajonin e Pelagonisë.

Veroret tradicionale më shpesh i kanë bërë nënat, edhe atë një ditë para ose herët në mëngjes para agimit më 1 mars ku janë të lidhura disa tradita specifike që kanë karakter magjik. Veroret janë përgatitur para lindjes së diellit që të neutralizohet fuqia, sepse besohet se nga një marsi fillonte dielli të nxeh më fortë.

Në tre fshatrat shqiptare të rrethit të Krushevis, Nerovë, Alldançe dhe Presill më 14 mars zhvillohet një ceremoni interesante lidhur me ditën e Verës. Fëmijët e këtyre fshatrave, në mëngjes ende pa lind dielli mbledhen në grupe dhe shkojnë prej një shtëpie në tjetër dhe para derës këndojnë si në kor:

Ciu – ciu

shum shqera

shum keça

për mi koke uve (vezë)

Pas kësaj çdo zonjë e shtëpisë i shpërblen fëmijët me nga një koke ve, disa bonbona, arra etj. Pasi kthehen në shtëpi fëmijët (pa dallim gjinie) te byzylykët dhe në qafë, lidhin penj të dredhur me ngjyrë të kuqe dhe të bardhë.

Materiali kryesor dhe themelor për bërjen e veroreve janë fjet e leshit dyngjyreshe të cilat i përdredhin. Më shumë pëlqehen ngjyra e kuqe dhe e bardhë. Një vend i konsiderueshëm në ritet e marsit zë dhe besimi i lashtë për ngjyrën e kuqe, për aftësinë e saj që të ruajë dhe të dëbojë të keqen. Kjo forcë pastruese dhe parandaluese e së kuqes në disa rajone lidhet me gjakun e të 40 martirëve, të derdhur gjatë këtij muaji.

Më shpesh veroret lidhen në vende të caktuara si: në dorë, në qafë, në gishtat e këmbës, në bërryl, nën dorëzat e këmishës, nën brez (te burrat, më shpesh te të rinjtë). Tani të rinjtë zakonisht e lidhin veroren në dorë dhe qafë që simbolizojnë pasuri dhe fuqi.. Dikur me verore nuk janë stolisur vetëm fëmijët, vajzat dhe gratë e reja, por janë stolisur edhe kafshët, pemët e ndryshme, vendet dhe veglat e ndryshme. Në strukturën e verores janë përfshi edhe elemente tjera, si para (argjendi, ari si dhe monedha të vjetra), zinxhirë hekuri, pjesë nga degët e thanës, arra, shtëpiza të kërmillit, bisht kali etj.

Në katundet shqiptare të Pelagonisë, si në Cërnilishtë, Desovë, Zhitoshë etj. në të kaluarën e largët veroren e kanë lidhur edhe në bagëti. Këtë rit me traditë të lashtë pagane e kanë zhvilluar që herët në mëngjes duke lidhur veroren kafshëve të ndryshme, gjë me të cilën lidhen shpresat e të zotit të shtëpisë për bereqet. Te kafshët më së shumti lidhen te qafa, veshët, rreth brirëve, në bishtin dhe në këmbën e kafshëve shtëpiake – kryesisht te të vegjlit.

Verore i kanë lidhur edhe në degët e pemëve, sepse ato do t'i ndihmojnë lëngjet pranverore në luftën e tyre me acarinë dimërore për të siguruar bollëk të frutave të shijshme dhe të ëmbla. P.sh. më një mars fshatarët kanë lidhur verore edhe në pemët në oborr, si dhe në sendet më të rëndësishme për gratë, si për shembull në furkë etj. Veroret janë lidhur edhe në stallë dhe kotec, në zgjedhën e qerres si dhe në sende të përditshme si në: tezgjahun, tundësin, parmendën, dy dorëzat e derës etj.

Ekzistojnë besime të ndryshme gjer kur duhet të mbahen veroret. Sipas disa besimeve ato duhet mbajtur deri më 9 mars ose deri më

25 mars, për shkak se ato data janë të lidhura me bereqetin, dallëndyshen, gjarpërinj, pemët e lulëzuara. Ka dhe një praktikë tjetër sipas së cilës ato duhet mbajtur vetëm deri më tre mars. Edhe më rrallë është praktika sipas së cilës veroret mbahen 40 ditë që gjer të korrat. Në Podgur të Kosovës veroren e bartin deri në Ditën e Shëngjergjit. [Xhemaj 2003: 230]. Shqiptarët e rajonit të Strugës veroret i mbajnë vetëm dy ditë më 13 e 14 mars [Vinca 1992: 22]. te shqiptarët e Pelagonisë veroren e mbajnë deri sa nuk shihet dallëndyshja, kurse në Nerovë, Presill dhe Alldançe derisa nuk shihet lelleku.

2. Vargje drejtuar zogjve shtegtarë për të sjell peshqesh dhe shëndet

Në kohëra të lashta tekstet kanë pasur karakter praktik, siç janë vargjet drejtuar dallëndyshes për ta shpënë veroren anës detit që t'u sjell njerëzve shëndet ose ndonjë peshqesh. Mendohej se verorja ka fuqi magjike që fëmijëve u sjell shëndet duke i ruajtur mos ngatërrohen gjatë ecjes. Ata mbahen në dorë në qafë ose në këmbë, deri sa nuk vijnë dallëndyshet. Në këtë mënyrë zogjve shtegtarë u jepet sihariqi i ardhjes së verës. Në fshatin Cërnilishtë të Prilepit dhe në Kranj të Prespës kur vinin dallëndyshet e para, ato vareshin në degë trëndafili, ose shege duke i kënduar dallëndyshes vargie duke shprehur urime për shëndet, gëzim e lumturi. Si p.sh:

dallnaishk – dallnaishk

faqe e kuqe

merre martinkën

nam ni kmaish

Cërnilishtë – Prilep (Ibrahimi 2003: 30)

“dallëndyshke, veshkëlushke,

nai verojkat, shpirmi n'det

sillmë bukë dhe shëndet!”

Kranjë – Prespë [Gega MF 237]

Në disa raste zogjve, sidomos atyre shtegtar u jepet sihariqi i ardhjes së verës, dhe përshkrimi i punëve dhe detyrat që i presin:

Dallnaishk – dallnaishk
faqe kuqe
a m'don uj, a m'don buk
nauk du uj, nauk du buk
e kaum nanën t'uj gat
e kaum babën t'uj laru
e kaum vllan tuj punu
e kaum motrën t'uj qenis
jem vet t'uj azdis

Cërnilishtë – Prilep [Ibrahimi 2003: 30].

Në disa këngë të këtij grupi shtjellohet edhe motivi i dashurisë ose i dasmave.

mali bubullon
fausha jeshilon
pranvera um gërkon
baba s'um marton
guguqja guguron

Cërnilishtë – Prilep [Ibrahimi 2003: 31]

Disa vargje të këtij tipi kanë karakter mitik. Ato i drejtohen hënës (*anxës*), duke i dëshiruar shëndet, forcë, bollëk, jetë të gjatë, bukuri, rritjen e flokëve etj.

anxa e re
sa ni palare
raitni fl'okët
nier përdhe
ose
ypa terma malit–o
zrypa teposht zallit–o
e pash anxën e malit–o
napër diegët e aishtes –o

Cërnilishtë – Prilep [Ibrahimi 2003: 31]

Pas dimrit të gjithë i gëzohen diellit, sepse ai paralajmëron pranverën dhe sigurinë e jetës dhe së shpejtë do të mbjellin shumë bimë dhe perime që nënkupton gjallërimin e jetesës.

*Diell–diell
koko diell
thamni duart
të t'jap
nji kup miell*

Alldançe – Prilep [Ibrahimi 2003: 32]

3. *Shikimi i zogjve në fluturim*

Me shëndetin lidhet edhe tradita që ka të bëjë me **shikimin e zogjve në fluturim**, sidomos ato shtegtarë, të cilët të parit e lajmërojnë ardhjen e pranverës. Ata që më së tepërmi i zbatojnë kërkesat tradicionale për mbajtjen e veroreve janë fëmijët. Ekziston besimi se, ai i cili më parë do t'i shikojë dallëndyshet dhe lejlekët në fluturim si dhe pemën e parë të lulëzuar do të jetë më punëtor se tjerët dhe puna do t'i shkojë mbarë gjatë tërë vitit, gjithashtu ata do të jenë të lehtë dhe të lëvizshëm, ashtu siç janë të lehtë dhe të lëvizshëm zogjtë në fluturim. Një besim të tillë ekziston edhe në fshatrat e Prilepit dhe Krushevës, p.sh. në fshatin Cërnilishtë të Prilepit [Ibrahimi 2003:30–31], ekziston besimi se ai i cili e shikon i pari lejlekun duke fluturuar do të jetë i shpejtë në punë, kurse nëse për herë të parë shihet lejleku duke qëndruar në tokë, besohet se ai do të jetë përtac tërë verën. Meqë *axhitë* (lejlekët) vijnë nga vendet e largëta fëmijët u urojnë mirëseardhje, duan t'ju sjellin ushqime, shëndet dhe të jenë më të fortë dhe më të shëndetshëm se ta:

*Axhi – axhi ballaban
nam ni lug sharllagan
të d'boj petlla për Bajram
ni sen tay ni sen mau*

kayja tane qull
kayja teme gur
 (Cërnilishtë– Prilep) [Ibrahimi 2003:31]

4. Këngët drejtuar rreziqeve që sjell marsi

Relikte të një trashëgimie kulturore të lashtë sjellin edhe këngët drejtuar rreziqeve që mund të sjellin muaj të caktuar të vitit, sidomos muajt e pranverës së hershme, kur koha fillon të ngrohet, dhe kur njerëzit mendojnë se dimri ka kaluar. Por shpesh herë kanë ndodhur befasi, kur papritmas koha është keqësuar dhe kanë ndodhur tragjedi të vërteta. Nga kjo njerëzit nëpërmjet këngëve i paralajmërojnë të tjerët të kenë kujdes, sepse e njëjta gjë mund t'i gjejë edhe ata. P.sh. te shqiptarët karakteristike ka qenë plaka e cila nga të ftohti është ngurosur në gurë. Në fshatin Cërnilishtë të Prilepit, ekziston legjenda për ngurosjen e plakës (Ibrahimi 2003:33), “*Ni plak, osh rrejt pi ditave d’grota t’marsit, osh nai n’mal t’i kullose dhit. Nauk i ka ngjau llafet e Sieçkut se osh erët t’shkuoje me kllot. Plaka e përqiesh marsin en aspak nauk i tremet, sepse mendon ce i ftohti ka kapërcet:*

Cic dhi maleve
t’ja dhjes
njekrën martit
kapërceti i ftohti

Mairpo, Seçku aq shaum osh idhnau en shkon ke prilli en i lutet:

Or prill be vlla
nam nja tre dit ua
jem i treti vet
t’ja boj plakës
si di vet

Paprait plakën pa vesh mair, e rrok ni acarai i madh en metet e graine n’mal, traum me dhit e vete. Ene suot e ksaj dite përmi Strajn gjindet ni gur ku shafet plaka e graine”.

(Cërnilishtë– Prilep) [Ibrahimi 2003:33]

Një variant tjetër e kemi regjistruar në Shipkovicë (në vitin 2004, nga plaka Nerxhivane Nuhii, amvise, pa shkollë): “*At mot pranvera plasi pak ma herët. Plaka e kishte sos zahiren. Seçku dul, erdhi Marti, ene une të dal ne bjeshk. Kam fânt djem e fânt reja, nëntëdhjet cop dhen pëllezja. I mori plaka dhent ene doli n’bjeshk. Atje e zateti Seçkin i tha, a nuk e sheh se është ende herët dhe mund te te mbajse fortuna. Plaka nisi ti livdohet t’ue than seçkit se taj ma shkove, vakti jot u sos, çashtajne ma erdhi Marti. Seçki aç shum u idhnu sa që me të ngarendme shkon te marti, ene i lutet Martit.*

*“Mart be vlla
gjem tre dit uha,
ta mbajti plakën
me gjith xhi ka”.*

Ene sot e kësaj dite plaka me dhent xhindet në stanet e Shipkovicës. Vendi ku xhindet plaka e ka emnin Stana Bora. Krejt kto jan të gdhendura në gur, edhe atë njëra plak me firkën ene me boshtin e tjerën leshin, kurse tjetra plak i krehën flokët, rejat me caullët jan mbledh kolla sofrës, kurse dhent jan tue kullot pak tiqe. Edhe sot e ksaj dite në fund të shkurtit dhe fillim të martit kur bie bor, populli thot “Ah këto plakat patjetër ta bëjnë atë të veten”.

Në të dyja gojëdhënat shihet gjyshja e cila është e njohur për sjelljen e saj kapriçoze, e nënçmon marsin duke u ballafaquar me pasojat. Kështu shpjegohet edhe ndezja e zjarrit tradicional më një mars, që sipas besimeve me të e ngrohin gjyshen Marta në pranverën e hershme. [Panajatova www.bnr.bg]

Përfundim

Në këtë ditë të gjithë popujt e Ballkanit dhe më gjerë, besnikët e fundmë të paganizmit; besnikë që pa dashur dhe pa ditur, rrethojnë me verore duart, qafën por edhe degët e thanave, të dëllinjave, të dafinave, të gjithë shelgjeve të nderuara. Këputin degë të gjelbra dhe i vënë përmbi kryet e shtëpive, duke sjellë kështu gëzim të kulluar në shtëpi.

Ani, se sot nuk bëhen përkujtime të denjë, për zojëzën e luleve, që grekët e quanin Persefoni, e ne Ditë Vere, megjithatë ka ardhur koha për metropolizimin e festave të lashta. Sidoqoftë pa ruajtjen e këtyre traditave mbetemi nostalgjik e të dhënë pas imazhit të vjetër, që padyshim i shkon më shumë për shtati shenjtërisë së perëndeshës së luleve.

Porosia universale për të gjithë krahinat shqiptare dhe më gjerë është t'i mos i lëmë të humbasin këto festa të vjetra të racës sonë. Nuk i bëjnë dëm njeriut. Sjellin një gëzim në çdo shtëpi, në një vend ku jeta e të vegjëlve është aq e trishtuar, djelmoshat dhe vajzat kanë një rast të rrallë për të dëfryer, sepse për fëmijët kjo është padyshim festë, kurse për të mëdhenjtë, Dita e Verës ka një shije poetike të hollë e të rrallë. Në ditët tona veroren duhet ta imponojmë si një përshëndetje pranverore – si një urim për shëndet dhe suksese, sepse edhe ashtu sot ajo është vepër artistike, element zbukurimi.

Informatorë:

Nurie Kadriu – e lindur në vitin 1956 në fshatin Cërnilishtë të Prilepit, amvise

Miraim Bajrami – i lindur në Nerovë, me profesion pedagog.

LITERATURA:

CELAKOSKI, Naum. (1973). *Proletnrite obi~ai i pesni vo Ohrid*. Makedonski Folklor god. VI, br. 12, Skopje 1973, (213–218).

DAJA, Ferid, *Les chants rituels féminins printaniers en Albanie*. Makedonski Folklor

DERVISHI, Nebi. (2005). Etnokultura e Fushëgropës së Ohrit 1. Tetovë (f. 329 – 330)

HAXHIHASANI Q. (1988). *»Hytje«: Lirika popullore I*, Tiranë.

HAXHI-PECOVA, Marika. (1963). *Prvi dan proleca u makedonskim obicajima*, Rad X Kongresa Saveza folklorista Jugoslavije u Mostaru i Trebinju 1962, Sarajevo 1963.

IBRAHIMI, Mustafa. (2003). *Thesari folklorik shqiptar nga rajoni i Pelagonisë*. Shkup.

IBRAHIMI, Mustafa. (2006). *Fuqia magjike e “verores” dhe “zogjët shtegtarë në fluturim” tek disa popuj të Ballkanit*. Simpoziumi i XVI Ndërkombëtar për Folklor. Ohër. (18–19. 10. 2006).

IBRAHIMI, Mustafa. (2012). *Dita e Verës si festë e trashëguar popullore dhe shndërrimi i saj në atraksion turistik*. Në konferencën me temë “Trashëgimia kulturore dhe turizmi në Maqedoni”. Strugë, (23–24 qershor 2012). Botuar në “SCUPI” , Vëllimi 3/ nr.3, Shkup 2012. f.175–194. Shkup.

IBRAHIMI, Mustafa. (2012). *Festimi i ditës së verës te shqiptarët dhe popujt e Ballkanit*. In *Zëri i Pelagonisë*, nr. 7–8/2015, pp. 3–20. Interlingua, Shkup, 2015.

KAVAEV, Filip (1973). *Proletni obi~ai od Struga*. Makedonski Folklor god.VI, br.12, Skopje 1973, (219–222).

KOMINO, Gjergj. (1955). *Këngë popullore lirike*. Tiranë.

LUTFIU, Mojsi. (1997). *Lojëra popullore dibrane*. Dibër.

MIKOV, Lubomir. (1994). *Bugarska narodna martenica – amulet i nakit*. The Magic and Aesthetic in the Folklore of Balkan Slavs, ed D. Ajdacic, Belgrade.

PANAJOTOVA, Rumjana ***Si mbahet verorja në Bullgari***. http://www.bnr.bg/radiobulgaria/emission_albanian/theme_folklor/material/marta_010306.htm

PENU{ISKI, Kiril,(1973). *Tematika na makedonskite proletni obredni pesni*, “Makedonski Folklor”, god. VI, br.12, Skopje.

POPOVSKI, Ariton. (1973). *Proletnite obi~ai i pesni kaj makedoncite–muslimani vo Reka (Debarsko)*. Makedonski Folklor god.VI, br.12, Skopje 1973, (203–211).

SALIH, Abdulah. (1973). *Prilog za prou~uvaweto na obi~aite okolu prvi mart kaj Turcite vo Ohrid*. Makedonski Folklor god.VI, br.12, Skopje 1973, (229–232).

TIRTA, Mark. (2004). *Mitologjia ndër shqiptarë*. Tiranë. (253–258)

TRAJKOSKI N. (1973). *Proletni obi~ai kaj Makedoncite i Vlasite vo Struga*. Makedonski Folklor god.VI, br.12, Skopje 1973, (223–227).

VINCA Nuhi. (1992). *Lirika popullore shqiptare në regjionin e Strugës*. Shkup.

XHEMAJ, Ukë. (2003). *Etnokultura shqiptare në Podgur*. Prishtinë.


ZEQIRJA, Neziri.(1997). *Letërsia gojore shqiptare*. Shkup.

NESHAT MEHMEDI

Organizator i manifestimit "Karnavalet ilire" në Bozovcë

DITA E VERËS

Dita e verës është një traditë e lashte pagane – shqiptare dhe festohet me një mori ritesh e praktikash të ndryshme në shumë treva tona, sidomos në Malësinë e Sharrit në katundet Bozovcë, Veshallë, Brodec, Vejcë, Shipkovicë, Lisec, Gajre,... Thuajse përfësisht ritet janë të njejta, por ka dallime të vogëla. Pra edhe një thënje e popullit thotë: “Katund e adet”. Kjo festë edhe pse është pagane s’është kundër as kujt e se dëmton as një njeri e as popullin – Thotë Konica, thjesht është pasuri e mëdhe kulturore e kombëtare. Për fat të keq në malësi se ka atë ritëm si dikur, pra shkon gjithnjë duke u zbehur, për këtë faj ka aty – këtu faktori njeri.



Përgatitjet për festimin e ditës së verës fillojnë shtatë ditë përpara, pra me shtatë mars kur praktika e përgatitjes së penjit **bardh e kuq ose kuq e bardh** është shumë e rëndësishme. Pra, në këtë ditë, vajzat dhe nuset e reja që janë të shëndetëshme e jo shëndetëliga dhe që i kanë të dy prindërit, të të gjitha lagjeve të katundit, zgjohen shumë herët dhe tjerin penjë të hollë (tajmën) në furkë i cili është i bardhë. Peri tjerret terma (përpjetë). Pasi e tjerin perin e bardhë, marrin pe të ngjyrës së kuqe dhe të dy bashkë i tjerin përpjetë deri në përfundim të materialit që do përdoret për festë. Më herët perin e bardhë e kanë tjer nga leshi i dhene (tjeri i bardhë më pas është ngjyrosur në ngjyrë të kuqe dhe e kanë shfritëzuar edhe për penj të ditës së verës), kuptohet kur të gjithë veshëmbathjet janë bërë nga leshi, ndërsa sot në mungesë të leshit, përdorin penj muline ngjyrë të bardhë dhe të kuqe. Po duhet të thekësohet se edhe këto penj i tjerin bashkë përpjetë në shtizë.

Fëmijët qofshin, vajza apo djemë presin në rradhë, kuptohet sipas ardhjes për të vëndu penj. Penjtë më parë i vëndojnë në dorën e djathtë, pastaj në të majtën dhe në qafë. Secilit fëmijë i vëndojnë penj aqë sa antarë numeron familja e tij e ngushte. Pra bartin pejnje për vetveten, për nënën, për babën, për babënlok (gjyshin) dhe nënënloke (gjyshen) dhe për aqë sa vëllezër e motra ka. Duhet të theksohet se penjë në duarë vëndojnë tek. Vajza apo nusja që u vëndos penjtë i pyetë: 'për kë vëndon penj (për kë vijësh pijë)?' Fëmija përgjigjet: 'për veten time ...', dhe kështu vazhdohet deri sa ti thotë të gjithë anëtarët e familjes. E nëse fëmijët harrojnë ndonjë anëtarë të familjes së ngushtë, ajo që ia vëndon penjtë e pyet: 'Po për Ilirin apo Albanën a nuk don të vesh penj?'. Fëmija ja kthen: 'po, po, dua, me vini (vëndoni) penjë'.

Penj në duarë vëndojnë nuset, vajzat e të tjerët në përjashtim të burrave. Për burrat vëndojnë bashkëshortet e tyre, qofshin burrat në shtëpi apo në gurbet. Beqarët vëndojnë pe vetem për veten e tij dhe të dashurën apo të fejuarën, por këtë nuk e shprehin hapur se është turp për rrethin ku jeton, por prapsepapë edhe djemtë kanë vënë penj dhe i kanë mbajtur të fshehur. Pra i kanë vëndosur në

pjesën e sipërme të krahut. Nuset i kanë vendosur vetëm në duarë e në raste të rralla i kanë mbajtur edhe në qafë. Në qafë kanë vënë vetëm përveten dhe bashkëshortin, dy penj e jo më shumë (gjithnjë numëri i penjëve të përgjithshëm të jet tek – bashkë me të duarëve). Nusja apo grua që ka gatuar ose është në rendin e maxhes ka vëndu penj vetem në dorën e majtë, ose në të dy duartë. Kur ka gatuar apo ka ftalluar penjtë i ka lëvizur pak më përpet . Penjtë vëndohen në duarë dhe qafë gjithnjë tek e jo çift, si te gjinia mashkullore ashtu edhe te gjinia femrore. Qëllimi është që të rinjët kur të martohen të trashigohen, pra të lindin fëmijë.

Penjtë e bardhë dhe të kuqë i vëndojnë, sepse ngjyra e bardhë simbolizon jetën e pastër dhe pa probleme shëndetësore dhe harmonin paqësore që duhet të mbretëroj gjatë tërë vitit në familje dhe në mes të anëtarëve. Pra të mos u ndodhë as një smundje , apo ndonjë e ligë si për vete ashtu dhe për antarët e familjes të ngusht dhe asaj më të gjërë. Ndërsa e kuqja simbolizon shëndetin e mirë apo të fortë dhe të gjithë e adhurojnë që të duken në pamje të kuq si molla e të fortë si thana.

Tjerrja përpetetë behet që shtëpia, anëtarët e familjes, bagëtia, të lashtat të kenë mbarësi. Fëmijët të rriten sikur lisi, bagëtia të shtohen, të lashtat të japin prodhime të medha. Pra shtëpia në përgjithësi të ec përpara pa kurrfarë pengesash.

Para se të vëndohen penjtë të gjithë anëtarët e familjes duhet të lahen në mbrëmje që trupi i tyre të jetë i pastër për ditën e nesërme, pra për ditën e penjëve. Penjtë si të vëndohen në duarë dhe qafë është e ndaluar të hiqen mbrenda këtyre shtatë ditëve e as të dëmtohen, sepse të gjithë bartësit duhet të mësohen të kenë durim, vendosmëri, sinqeritet, dëgjueshmëri familjare dhe të zbatojnë rregullat në përpikëri nga ma i vogli e deri te më i moshuari i familjes. Nëse ndodhë rastësisht të kuputen penjtë s'është mirë të vëndohen në dorë apo qafë, po penjtë e zgjidhur apo të këputur duhet të vëndohen në një pemë apo dru frutor. Ashtu si jep frute pema të ketë begati edhe vet personi dhe familja e tijë apo e saj.

Atëherë pse sbënë të vëndohen përsëri në dorë ose qafë penjtë?

Femrës apo mashkllit që i janë këputur penjtë nga dora ose qafa është një shenjë negative për fatin e tyre. Nëse vajza apo djali janë të fejuar besohet se mund të ndodhë që këta të fejuar apo të martuar mund të ndahen, ose mund të ju ndodh edhe ndo një fatkeqësi ma e madhe ndërmjet tyre, që njëri nga të fejuariët apo të martuarit mund të humb jetën. Pra besohet se nëse këputen penjtë dhe si vendos përsëri në dorë apo qafë , por i vendos në një pemë frutore. Pema do i merrë të gjitha të këqiat e mundëshme të të rinjëve , të martuarëve do t'ju sjell fat dhe lumturi në vazhdimësi. Nëse ndodh që penjtë e këputur i vëndojnë në një pemë të thatë apo dru jo frutor se shohin me si të mirë.Druri i thatë dhe jo frutor llogariten si bimë jo të vazhdimësisë jetësore, jo e pjellores dhe shumimit – ska jetë, jo e gjallërisë.

Këto penj pas ditës së shtatë bashkohen me penjtë tjerë. Ditën e shtatë përsëri lahen të gjithë anetarët e familjes që të jenë të pastër për ditën e nesërme, ditën e verës kur i presin penjtë. Penjtë i presin herët në mëngjes vajzat apo nuset që janë më punetore në shtëpi(ashtu si janë punëtore këta të bhen punëtorë edhe atyre që ju presin penjtë). Po në këtë ditë i presin edhe flokët nga tre centimetra, më shumë vajzat, nuset, por edhe të rinjtë meshkuj, por ata shumë më rrallë.Flokët i pret ai—ajo që e ka dorën e lehtë, që zgjohet herët dhe është punëtor/e.

Para se të priten floket merret një tërkuzë (litar), një rrahëse (Dru shpatuke me dorezë që shërben për të rrahur rrobat kur i lajmë) dhe i vëndojnë ato në prag të shtëpise. Cuca (vajza) ulet mbi rrahëse, ndërsa ai/ajo që i pret flokët thotë:

- Sot një javë sa një dardhë
- sot një mujë sa një dujë
- sot një motmot sa një plep

Në rrahëse, te pragu i derës ulen vajzat që floktë t'ju bëhen të trasha e të gjëra sikur rrahësja. Ndërsa tërkuzën e afrojnë aty afër që flokët t'ju bëhen të gjata sa tërkuzat. Pastaj flokët i hudhin në lum, duke

thënë tri herë: çashtau si shkon ujë, çashtau u rrajtshin flokët (në k. Brodec) në Bozovcë dhe Veshallë thonë si hecën ujë u rrajtshin flokët, pastaj vazhdojnë duke thënë tre herë: ” merrmi t’ligjat e ma jep shënetin”.

Flokët çdoherë kur i kanë qethur, të njejtat llafe i kanë thënë . (Flokët e hekme sban ti shkelin qerët njerëz, sepse aj xhi i ka hek i dhamën krajet për atë duhet ti flugjin n’ ujë. Kallzoi: M.M, M. R.)



Penjtë i lidhin rrumbullake në një tufë që të duken sa më te heshëm (më bukur). Ndërsa pjesët e prera i mbajnë në një skutaçe – strukë dhe pas përfundimit të punës i mbështjellin në një letër apo kind dhe kur shkojnë në lum i hudhin në ujë, duke bërë të njejtin adet si të flokëve). Zakoni është që secila shtëpi apo lagje të shkojë më parë te lumi e ti varin sa më lartë penjtë në një drur të fortë: të thanës, lisit (ahut),... po në mungesë të thanës në Veshallë dhe Bozovcë i kanë vendosur në drur të shelines së egër dhe në drur të plepit afër ujtë – përroit ose lumit. Ashtu si shtohet e rritet shpejt shelnja e egër pranë ujit, të shtohen e të rriten familja, fëmijët, bagëtia, të lashtat e të tjera. Pra fletë shumë pse njerzit kanë vlerësuar shumë ujnë, zjarrin, dillin, yllin, hënën. Këta janë kushtet elementare të jetës, të gjallërisë, e të pjellores. Pasi i varin penjtë në drur i lajnë sytë në

lumë që të jua lëshojnë gjumin e të ligat të tjerëve. Kur i lajnë sytë thonë: “ujë teposhtë shëneti terma (përpjetë)”, këtë e përsëritin tri herë, poashtu thonë;” ashtu si ecën ujë ene t’ligjat i marrt me viti “ kallzoi M.R



Në lumë mbushin ujë në një enë bakëri dhe mbrenda enës futin gurëz, rërë, thejnë degë dashedele (lule nga lejthiat), maca (lule të shelveve) marauçka apo miza përdhese – milingona (Ashtu si është bakëri i fort dhe i qëndrueshëm, ashtu të bëhen të fort dhe të qëndrueshëm antarët e familjes, bagëtia, të lashtat e të tjera, ndërsa degët e dashedeleve dhe të macave simbolizojnë ardhjen e pranëverës, pjellshmërin e natyrës, begatit e shumta buqësore,...). Degët e dashedeleve dhe të macave s’bënë t’i lëshojnë në tokë, sepse pragu i shtëpisë do ketë probleme me shëndetin – pra sdo të ketë mbarësi si në mes të anëtarëve ashtu edhe në bagëti dhe të lashtat– drithërat, pemë e perime. (Pra dergjin antarët e familjes në shtrat, të lashtat e mbjellura; drithrat, pemët, perimet mund të dëmtohen nga reshjet). Kur shkojnë në shtëpi degët i vëndojnë në çdo derë e dritare të shtëpisë, por edhe te hambarët e drithit dhe në manxhe të bukës...

Gurëzit i futin që antarët e familjes dhe gjëja e gjall të jenë të fort si guri, që të jenë të qëndrueshëm ndaj kushteve klimatike, ndaj semundjeve ngjitëse, të jenë imun, ndërsa milingonat i futin me qëllim që edhe anëtarët e familjes të jenë punëtorë si ato dhe të shtohen fëmijët, dhentë, ... Pra si shtohen milingonat të shtohen familjet, bagëtia dhe të lashtat.

Këtë ditë kur kthehen nga lumi me ujë stërpikin derën e madhe hyrëse të shtëpisë, lëmën, pragun e shtëpisë, shkallët, dhomat, shtratin e fjetjes, dritaret, anëtarët e shtëpisë, fëmijët që flejnë, teshat, shtëpin e zjarrit, lugjanikun – boskën (ku janë mbajtur lugët, qepa, krypa, biberi), kafshët, Hambarët – dritherat, bylmetin... Ujë u japin të pijnë anëtarëve të familjes dhe ujë u shtin në gjellë

kafshëve. Enën me ujë ia japin një djali apo vajze që është i fort e i shëndetshëm dhe që e do punën, përndryshe s'bënë që ti spërkat njerëzit ai djali apo vajzë që është shëndetligë apo i mungon njëri prind (nuk bane t'i stërpajke njerëzit aj gjali e ajo cauca xhi është shënet ligj e xhi se do punën, e stërpajkmja bahet pa dallaue moshën e gjininë.”Kallzoi: Merxhivane M. Njerëzit e pijnë ujin që të jenë të shëndetshëm, të pastër në shpirt, trup e mendje, të qëndrueshëm e të sakrificës e të ju sjellë shumë mbarësi. Ndërsa kafshëve u japin ujë që të lëshojnë qumështe e të shtohen ashtu si rrjedha e lumit apo e përroit që shtohen në pranverë.

Poashtu nëpr derët e dhomave të shtëpisë, hambarë, në maxhe të bukëve, lugjanikë (boskë), sofër, kuër, ahur, izbë, shtëpi të zjarrit (vatër),... vëndojnë dashedele(nga druri i lajthisë) dhe maca nga shelnë etj. Në këtë kohë të muajit mars lulet vështir i gjen në këto fshatra të Maësisë së Sharrit, sepse lartësia mbidetare është mbi 1.300 m. Atëherë banorët janë të detyruar të thejnë këto degë nga binët drurore siç janë macat nga sheluja e egër dhe dashedele nga lajthia.

Për Ditë Vere, gratë lidhin penj në dru të thatë.

Druri i thatë më i përshtatshëm për me bë magji është ferra.Ashtu si është ferra e thatë dhe e dobët, ashtu të thahen e të dobësohen armiqët e popullit, të familjes dhe bagëtisë dhe dëmtoresh e kafshëve, pemëve, perimeve dhe të lashtave.

Penjtë që i lidhin në ferrë apo në dru të thatë për me bë magji duhet të ketë ngjyrën e zezë. “Njanin qosh të pinit e lidhin për degjin e ferrës të thatë, ene pas çdo përgjigjeje pini lidhet naje. Çashtu si është druri i thatë ene pini i zi, dushmajëve dhe dëmtoreshë tju shkoj viti e jeta vetëm me ngjarje të zeza”; (Gjithënjë, aty afër kanë patur me vete fëmijë që ti dëgjojnë këto biseda, pra që edhe fëmijët të informohen e të mësojnë për armiqët e shumtë të popullit tonë, që kanë bërë kërdi e masakra të pa llogaritëshme ndaj shqiptarëve ku do qofshin anë e mbanë trojeve shqiptare: therrur,

vrare, djegur, ...e dëbuar popullatën, pa dallim moshe e gjinie, vetëm e vetëm pse janë shqiptarë... po ashtu i kanë njoftuar edhe për kafshët e egra mishëngënese (ariun, ujkun, dhelprën) dhe kafshët dëmtuese të bimëve dhe të perimeve (derrin, urithin, lepurin, miu...), të din për gjarpërin krimbat, moknat – mokërrat e të tjera.Pra qëllimi kaqen shumë edukativë dhe mësimor. Gjithënjë duke patur parasysh mohimin e shkollimit që na e kanë bërë armiqtë gjatë shekujve me rradhë gjatë robritit, atëherë rol kyq në edukimin dhe dhënien e njohurive e ka bërë familja gjatë rriteve dhe festave të shumta të motmotit – vitit.

Nga kjo shihet qartë se; familja ka qenë baza ose themeli ku janë marr edukata, diturit dhe njohurit e ndryshme të mësimin e këshillave pozitive për tu përballur me jetën dhe vështërsit e përditëshme.

Gjatë këtij riti njëra pyetën e tjetra përgjigjet (fëmijët dëgjojnë), ndërsa ajo që lidh një perin i përgjigjet:

- – Për ka lidhish?
- – Lidhi askerin, se ka hanxhar (Thikë e madhe dhe e gjatë, me dy presa e me majë të hollë, që përdorej si armë. Luftonin me hanxharë.), pushkën n’dorë, se vret, se prët se gjrjën, zoti ja farkoft e gjozhdoftë durët, ene kamët e mo baje qederë.
- Për cajllin dushman?
- Për dushmajt e milletit tonë, katoaunit tonë e familjes e farefajsit tonë, xhi na kanë therr, vra, gjege ,shkrumaue me njerëz, xha e drithna
- – Për kalidhish?
- – Lidhi për derat, se na i ha kompirat – patatet, kollomoçin, tërsënën, ...
- Gjoja u farkoftë e ju gjozhdoftë
- – Për ka lidhish—?
- – Lidhi për ukin, mos na i haje dhentë, koltë, lopët, dhojtë...
- – Gjoja ju farkoft e ju gjozhdoftë
- – për ka lidhish?
- – lidhi për araushën, mos i haje lopet, dhentë, dhojtë...

- – gjoja ju farkoft e ju gjozhdoftë
- – për ka lidhish
- – lidhi për dhelprën, mos na i haje pulat, patat...,
- – gjoja ju farkoft e ju gjozhdoftë
- – për ka lidhish?
- – lidhi për leprin, mos na i haje tërshënat, perimet,...
- – gjoja ju farkoft e ju gjozhdoftë
- – për ka lidhish?
- – lidhi për buklën mo na i haje pulat
- – gjoja ju farkoft e jugjozhdoft
- – për ka lidhish?
- – për bollën e xharpnin.
- – gjoja u farkoft e ju gjozhdoftë mo na i thajthin lopët...e mona i kaçe caullët...
- – për kë lidhish ?
- – për majnin, krajmin, molzën

Është mirë me përmend se në katund, në ditën e verës ata gra që skanë patur mundësi me shku për me i çu penjtë te lumi e me i var në drur, i kanë angazhuar fëmijët me shku me gratë e fëmijët e lagjes, e në raste të rralla penjtë i kan var në kopsht, në dru frutor, ashtu si lulëzon pema, ashtu të lulëzoj shtëpia me njerëz, bagëtia e të lashtat, ndërsa lidhjen me perin e zi e praktikojnë në zinxhirët në furë të oxhakut. Pra njejtë sikur te fera e thatë, njëra e pyet e tjetra i përgjigjet.

Banorët e këtyre katundeve, kanë lidhur zinxhirët e oxhakut të furrës në shtëpin e zjarrit, çdoherë kur kanë mbetur kafshët në fushë, mal dhe bjeshkë. Pra i kanë lidhur tre herë një, duke përsëritur fjalët pa e përmendur emrin e ujkut apo ariut. “Kshtau si janë lidh zinxhajrat çashtau vu lidht gjoja, ju farkoft e ju gjozhdoftë farkofshive”

Kur kthehen nga Dita e Verës

Dy gra marrin ujë të valuar në një enë dhe e vënë në prag të dhomës. Njëra qëndron jashtë pragut të dhomës, e tjetra mbrenda në dhomë. Ajo që është jashtë dhomës, me një krënde përzien dheun me ujin valë, ndërsa ajo që është mbrenda në dhomë e pyet gruan që është jashtë:

- – Xhi bajsh oj shoqe?
- – I përvloj moknat.
- – Xhibajsh oj shoqe?
- – I përvloj pleshtat.
- – Xhi bajsh oj shoqe?
- – I largoj llomet e kit dimnit.
- – Xhi bajsh oj shoqe?
- – I përvloj morat
- – xhi bajsh oj shoqe
- – i përvloj molzat...

Shembulli i dytë; Ndryshimet vërehen kudo, në çdo lagje, në çdo katund, por në thelb janë të njejta: Nga të katër qoshet e dhomës kanë kruar me maje të thikës botë – dhe, dhe e vëndojnë në katër pjata në çdo qoshe të dhomës. (Deri aty në vitet e nëntëdhjeta, çdo dhomë fundin e murit e ka patur të lyer me botë ngjyrë të kuqe, në një lartësi deri pesëdhjetë centimetre). Marrin ujin e valuar në çajnik apo xhezve dhe e përvëlojnë botën, në të katër qoshet e dhomës, dy gratë në këtë mënyrë veprojnë:

- Xhi përvlojsh?
- Përvloj moknat, pleshtat, morat... se na pajkin napër shpoj, napër enë,...

Ne katundi Bozovcë, Veshallë, Vejcë të Malsisë së Sharrit përvëlojnë katër qoshet e manxhes, për me i përvaluar molzën..

Në katundin Veshalle për ditën e veres mbledhen hithri, dhe te pragu i derës pyetet tri here: ‘Oj e zoja e shpijsë, xhi duësh, a hithit a pleshtat? Ajo tjetra i përgjigjet po ashtu tri herë: ‘Hithit i due, pleshtat si due. Hithit i shtojnë n’gjirosh”S. M

Natën e ditës martë, (të martës parë) për ditën e verës e vlojnë ujin. Dhe pastaj në katër skajet e dhomës e derdhin atë ujë me qëllim që të përvlojnë:

- – xhi përvlojsh?
- – përvloj moknat, se nahijn napër bukë, napërujë.
- – xhi përvlojsh?
- – përvloj pleshtat
- – xhi përvlojsh?
- – Përvloj morat

Pra, dita për të përvëluar moknat patjetër duhet të jetë ditë e martë, pas ditës së verës .

Kur vajnë muj i gjate (marsi) në koritë do shtojnë duj t'gjatë, është zakon që të lahen caucat (vajzat) dhe të krehen duke përsëritur fjalët:”kamët n’ujë, flokët duj u rajtshin sikur hecën ujë, sikur rajtet duj (duaj)” Kallzoi:S.E.

Cucat në raste të rralla Përditë Vere i presin edhe flokët te lumi dhe i hedhin në lum duke thënë: ‘sikur hecën ujë ,çashtau flokët e shëneti hecë’ kallzoi:D.M

Poashtu, trijavë para ditës se verës mbeturinat (berllogun) i mbledhin në një vendë të caktuar mbrenda në shtëpi, me qëllim që bereqeti të mos ik nga shtëpia. Pas ditës së verës ato hudhen në lum.Duke thënë:

Ujë teposhë shëneti terma (nga tri here)

Ujë teposhë bereqeti terma

Ujë teposhë xhëja terma (Kallzoi: A.Reshiti)

Ditën e Verës nuk lejohet shpim i çfarëdo gjëje qoftë, sepse u prishet gjini dhenëve, lopëve, dhive, ndërsa kuajtë , mushkat dhe gomerët i zenë samari.

Nuk lejohet te shkunden jorganat, plafat, postiqet, sepse besohet se arat e mbjellura shkunden nga era, breshëri dhe shiu.

Bletari

Në Ditën e Verës bletari bënë matjen e koshit të bletëve. Ai matjen e bënë me hapa apo pëllëmbë, nga koshi e deri te dera e shtëpisë. Matja mvaret se me çfarë do të bëhet, me pëllëmbë apo hapa, kjo do të mvaret nga largësia e bletëve. Nese matja e bërë del me numer tek, bletët do te gjuditin (goditen), por nese matja del çift ato nuk gjuditin, nuk janë të goditura.

Për Ditën e Verës, të gjithë familjet ziejnë (kokërra) misri me hi (fojë) dhe gatuajnë fli. Shtrohet pyetja pse kanë vënë me zjerrë kokra misri? Kora e misrit të tharë është shumë e fortë dhe qëndrueshme. Ashtu si është e fortë kokra e misërit ashtu duhet të bëhen të fortë, e të shëndetshëm anëtarët e familjes. (Zjerrjen e kokrave të misrit më herët në katundet e malsisë e kanë bërë rregullisht në scilën javë në çdo shtëpi të katundit. Është thënë se është ushqim shumë i shëndetshëm).

Gatuajnë flij që ashtu si vëndohen rendat në tepsi ashtu punët në shtëpi të shkojnë me rend e mbarë, pakurfar problemi e vështirësie gjatë tërë vitit. Pra si punët mbrenda shtëpisë dhe punët jashtë shtëpisë duhet të vëndohen përpara e të kryhen kollaj.

Këtë ditë e festojnë të gjithë vajzat e lagjeve me këngë dhe me lojra të ndryshme po të përcjellura me këngë, si psh: loja kumterëm kumterëm, shalemale, dhe loja në shiluër(kolovitje). Shilurin e vëndojnë në një degë peme, po të fortë dhe shiluren një nga një, po edhe nga dy përnjëherë, po të përcjellura me këngë.

Loja Shalemale dhe kumterëm – kumterëm luhet nëpër rrugët e lagjes, por në grupe – grupe e në lagje më lagje. Jo vetëm gjatë festave , por edhe gjatë ditëve të përditëshme para mbrëmjes, kuptohet në ditët e stinës së vonshme të vjeshtës, dimrit dhe pranverës së hershme. Megjithatë këto lojra të përmendura thuajse po zhduken dalngadale.

1

Do shkojm për lule napër ara
 Macat u hashin dacat u përleshin
 Delet u tremshin, desht u vrajtshin
 Ditvere mori top sheqere

09.III.97. F. I

2

ditë vere sa e majra kane
 o kofsh për ditën tane
 ditë vere sa e majra ishe
 o ditën tane ma kishe

3

he mori taj lulja e heshme
 ku m'i pahe çel
 nja nij javë para ditë-verës
 çagje me nij ven
 çagje me nij ven ore sajvi zi
 e pkuta lulen e heshme ta çova tij
 ça gje me nij ven ore shtat bajrak
 e pkuta lulen e heshme e fajta n'bardak
 4 Kënga **kumterëm terëm –terëm**

na ka hup nij shoçe haj
 ku u na ka hup haj
 kumterëm terëm–terëm
 na ka hup në male haj
 kumterëm terëm –terëm
 uki va ka ngran haj
 kumterëm terëm–term
 ju na kini marr haj
 kumterëm terëm–terëm
 far shamije kishte haj
 kumterëm–terëm–terëm

shamij me molla haj
 kunterëm terëm–terëm
 far fanille kishte haj
 kunterëm terëm–terëm
 fanellën me vija haj
 kunterëm–terëm–terëm
 far dimija kishte haj
 kunterëm terëm–terëm
 dimija mavije haj
 kunterëm terëm–terëm
 far skutaçe kishte haj
 kunterëm terëm–terëm
 skutaçen e bardh haj
 kunterëm terëm–terëm
 far nalle mi kishte haj
 kunterëm terëm–terëm
 nalle pi Shkupit haj
 kunterëm terëm–terëm
 banu shoçe gati e hajde me ne
 kunterëm terëm–terëm

Kënga **Hor kale për kale** Këndohet në katundin Veshallë
 Ndërsa në katundin Bozovcë këndohet **hor kala për kala**
 Po na vajnë nja dij delije
 Hor kala për kala
 Dil e gjedhe i lumi bijë
 Hor kala për kala
 Udhën ta kam shlue
 Hor kala për kala
 S'të kanet me shkue
 Hor kala për kala
 Nauk të shloj mori nauk të shloj
 Çat sojzezën da porgjoj
 Hor kala për kala

Do na vajn o pi gurbeti
Hor kala për kala
Do na bijën gjima salepi
Hor kala për kala
Çe te vajnë pi anadulli
Do na bijën topa mori
Hor kala për kala
Çe te vajnë pi allbanije
Do na bijën topa qafije
Hor kala për kala
Do na vajnë pi sheri
Do na bijën lule veri
Hor kala për kala
Po na vajnë nja dij delije
Ishin veshët me jënlije
Hor kala për kala
Shloma udhën se S'të ngas
Për ni dore dot vërvas
Hor kala për kala
Pse m'vërvasësh more gjal
E kam menen unë tët marr
Hor kala për kala

Ditëvere mori dilbere
sikur sivet ardhsh përhere
ene n'mot ene n'qetër mot
o hala imi shoçe plot
do na vaje dita sikur sot

H. M

Hëna e bardhë

Është tre ditë pas ditës së verës “Hëna e Bardhë”. Në këtë ditë njerzit e shtëpis nuk punojnë këto punë:

– Miell nuk sitin

– Nuk shkundin – trëndin

– Nuk shpojnë

Në të tretën ditë familjet e katundarëve duhet të jenë të përgatituri me pas bukë, sepse në këtë ditë nuk lejohet të sitet miell në shtëpi, sepse “Çshtu si sajtet majlli në sajte, çashtau do shkUNET bereqeti napër ara: elbi, tërshana, thekni, gjruni... pi erës madhe” H.M

Teshat, mbulusat – jorgonat, dyshekët, plafat, çarçafët... s’bënë të shkunden në këtë ditë, sepse ashtu si e trënd apo i shkund mbulusat ashtu do të shkunden nga era dhe breshëri të lashtat.

Në të tretën ditë nuk lejohet të qepin apo të arnojnë; pantallona, pëlhura, plafa, këmisha. Qëllimi është sipas këtij riti që koltë, mushkat, gomerët mos i zen samari, ndërsa dhenëve, lopëve, dhijëve ... mos ju prishet gjiri.

Para Ditës Verës kemi edhe rite (festa) të tjera: Midis dimrin...

RINI USEINI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore
të Shqiptarëve – Shkup*

DITA E VERËS NË STRUGË DHE SIMBOLIKA E SAJ

Dita e Verës, që në realitet shënon fillimin e stinës pranverore e që lidhet me ekuinoksin pranveror (saditanata), në kalendarin popullor të punës njihet si Ditë e Verës (nji marsi), që sipas kalendarit të vjetër të i bie më 14 mars. Është njëra nga ditët e mirëpritura, e cila bie në kohën e përtëritjes së natyrës dhe të fillimit të punëve në bujqësi. Për këtë në disa vise shqiptare konsiderohej edhe si kryevit, pra si Vit i ri, apo Kryemot.¹²

Në aspektin e ciklit vjetor të kalendarit popullor në parim Dita e Verës ka funksionin e njëjtë me festat e tjera të tipit të vetë, para së gjithash kërkimin deri në sakrifikim për te mirat që ti sjell natyra. Mbi të gjitha më së shumti në këtë mori ritualesh me karakter imitativo-magjik rëndësi të madhe i jepet kultit të vegjetacionit apo bimëve që japin sinjalin e parë për mbërritjen e momenteve kur toka ka nevojë për më shumë kujdes, pas shpërthimit të saj. Në këtë mori ritualesh përfshihet edhe bota e pjellorisë induktive e përfaqësuar me vezët të cilat janë të pranishme gjatë gjithë fazës së ditës së verës, e cila ka parafazën dhe post fazën e saj. Veza është simbol i kozmosit, i rigjenerimit dhe i ripërtëritjes së jetës. Si tjetër mënyrë trajtese religjioze e paganizmit paraqitet dhe animizmi i cili përfaqësohet në mënyrë metaforike nëpërmjet të kultit ndaj faunës e posaçërisht ciklit fillestar të simbolikës faunore siç janë zogjtë, ato

¹² Tirta Mark, “ *Kulte të bujqësisë dhe blegtorisë në popullin tonë*”, tek *Etnografia shqiptare*, IX/1980, 162

parafrazohen nëpërmjet të degëve të vogla që fëmijët i mbledhin para se të shkojnë te secila shtëpi për të marrë ndonjë dhuratë dhe më e pëlqyeshme është veza, me numrin e të cilëve krenohen dhe vetë ekzekutuesit e ritualit, kuptohet në këtë rast fëmijët. Ky kult paraqitet edhe nëpërmjet të mbulimit zanor, pra, në momentin kur fëmijët arrijnë në shtëpinë e dikujt thonë disa herë *ciu ciu*, sikurse bëjnë dhe zogjët e vegjël. Por ky veprim mund të bartë dhe të fshehtat e natyrës apo kalimin e shpirtit të animizmit nga fëmija që është si interpretues i zërit të zogjve tek degët e vogla (karthëjat), të cilët marrin rolin e zogjve.

Me rëndësi të madhe në këto ditë të shënuara të kryemotit është dhe përdorimi i vezëve, të cilët në aspektin ritual mund ti quajmë edhe si vezë rituale. Veza paraqet një rekuizitë me peshë në të gjitha ritet e festave kalendarike. Ajo, sidomos përdoret në ato festa në të cilat bëhet kalimi në një periudhë kohore të re. Në këtë drejtim edhe Dita e Verës, por edhe Shëngjergji të shqiptarët e Maqedonisë, kanë qenë të përshtatshëm për përdorimin ritual të saj. Kështu në rajonin e Kërçovës “për këtë festë fetare që bie me 6 maj, pra në ditën e Shëngjergjit, zihen dhe ngjyrosen vezë të kuqe me të cilat fëmijët thyhen njëri-tjetrin për të provuar se cila vezë do të jetë më e fortë ose cili prej tyre do të fitoj; me vezë të kuqe e me lule Shëngjergji fëmijët nënat i lanin që tu ecë mbarë shëndeti dhe të jenë të shenjtëruar.”¹³ E njëjta ndodh dhe në rajonin e Strugës kur vezët ngjyrën e marrin nga lëvozhgat e qepëve të cilat i ziejnë bashkë me vezët, ato paraprakisht janë në numrin e paramenduar nga amvisja se sa fëmijë mund të vijnë, duke i përshtirë dhe anëtarët e familjes në këtë numër, kurse vezët nga lëngu i lëvozhgave marrin ngjyrë të kuqe.

Veza ka qenë e pranishme edhe në kohët më të vjetra. Ajo luan rol të madh në mitologjinë dhe religjionin e shumë popujve. Miti

¹³ Qemal Murati, *Shënime etnografike nga rrethina e Kërçovës (Festa dhe rite fetare, doke e zakone familjare)*, Jehona, Nr.9-10, Shkup, 1995, f.61.

kozmozgonik për krijimin e botës nga veza është i njohur për shumë popuj të botës: fenikasit, babilonasit, egjiptianët, hindusët, japonezët, kinezët, grekët etj. Veza është burim dhe simbol i jetës, Prania e saj në sistemin e riteve të Ditës së Verës është e ndërlidhur me besimin se veza nga njëra anë paraqet burim të krijimit, fuqisë dhe jetës, kurse nga ana tjetër, veza e ngjyrosur konsiderohet si mbrojtëse nga sëmundjet, fatkeqësitë elementare etj. Thyerja e vezës gjatë riteve të Ditës së Verës paraqet lindje ciklike të një faze të re, siç është periudha e lulëzimit të vegjetacionit. Veza, përveç ndërlidhjes me simbolikën e lindjes, kishte edhe simbolikën e mirëqenies shëndetësore, qoftë për njerëzit, poashtu edhe për kafshët shtëpiake. Në këtë kontekst, në ditën e Verës në kasollen dhe kotaren e pulave vendoheshin gjithashtu një lule kukureku pasi mendohej se sipas logjikës së magjisë imitative ato do të ishin të shëndetshme dhe më të mira për dhënie e qumështit.¹⁴

Kulti i *rrethit të mbyllur*, që përfaqëson bashkësinë familjare paraqitet te ushqimi tradicional i Strugës i quajtur *kollbirek*. Kjo festë është tipike, sepse është dita kur kërkohet nga forcat mbinatyrore përveç begatisë edhe mbrojtja nga qeniet e errëta mistike. Kjo më së miri pasqyrohet te peri i kuq dhe i bardhë i cili thuret nga zonja e shtëpisë me shumë dëlirësi.

Peri i quajtur *verore* e diku si *sinjelk* ne fshatin Pohum e të tjerë, vendohet në bilizikun e dorës së djathtë, me qëllim që t'i mundin qyqet, e dallëndyshet sepse nëse mund të të mundin atëherë gjatë gjithë verës do na vjen era e keqe në gojë. Prandaj fëmijët dhe të rriturit kanë marrë një copë bukë me vete, një copë të vogël apo "*kamçëjt*" që të mos jenë pa ngrënë dhe në këtë mënyrë e mundin qyqen etj. Nëse qyqja bënë ku – ku – ku e jemi pa ngrënë atëherë të mund shpendi. Perin e kanë vendosur të gjithë pa dallim moshe apo gjinie. Verore kanë venduar dhe te gishti i madh i këmbës së

¹⁴ Izaim Murtezani, *Festa e Shëngjergjit te Shqiptarët e Maqedonisë*, Sak Stil, Shkup, 2010, f.33

djathtë me qëllim që të mos pengohen dhe rrëzohen gjatë gjithë verës. Me të njëjtin qëllim kanë venduar dhe në bizilikun e këmbës së djathtë që t'ju shkoj viti i mbarë dhe të mos rrëzohen.

Nga tëra këto elemente që plotësojnë kremtimin e kësaj kremte në kohën e saj të harresës, në origjinë flasin për një sërë ritesh që kishin të bënin me natyrën, ringjalljen e saj, fillimin e punëve në bujqësi dhe me shëndetin familjar.

Origjinën e kësaj kremteje M.Tirta e sheh në lidhje me vitin e ri të romakëve të lashtë, i cili fillonte më 1 mars, por duke e konsideruar gjithnjë të tabanit autokton me mundësin e ndikimeve eventuale të cilat do të vinin më tepër si ngjashmëri e vetë riteve dhe e karakterit të tzre të lashtë e pagan.

Në lidhshmëri me këtë festë ruhet besimi i një kremte, po ashtu të lashtë, por që tash shfaqet e ngatërruar data e kremtimit. Fjala është për ditën e përtëritjes së natyrës (që bie më 25 mars). Për këtë ditë ruhet besimi i ringjalljes së natyrës dhe ende respektohet rregulla, që dikur ishte normë të thuash e kanunuar, që të mos prehen drunjtë këto ditë. Sipas besimit popullor, cdo bimë, dru (i njomë) atë ditë ringjallet nga gjumi dimëror. Ato marrin frymë, ushqehen, dëgjojnë, por vetëm nuk mund të flasin apo nuk kanë gojë, thonë populli. Shihet këtu një analogji me jetën e njerëzve. Në mitologjinë e popujve me kulturë të lashtë, e posaçërisht në atë indoeuropiane Toka simbolizon hyjnin e gjinisë femërore me aftësi të ripërtëritjes së jetës. Nga ajo lindi bota e gjallë dhe asaj duhet ti kthehet e vdekur, për tu ringjallur përsëri. Dhe në mes të formave të jetës që kanë prejardhje nga toka mëmë më e zhvilluar është simbolika e vegjetacionit, posaçërisht simbolika e drurit, e cila simbolizon jetën. Në origjinë këto relikte paraqesin gjurmë të një besimi të lashtë që të shpie ne thellësi deri në shtresëzimet arkaike

paleoballkanike e që ka të bëjë me kultin e pjellorisë së tokës, përkatësisht të bujqësisë, të ndërlidhur me kultin e drurit.¹⁵

Në fakt praktika e ditës së verës sikur të gjitha festat tjera të kryemotit fillon një ditë para apo më 13 mars, e quajtur si dita e Arifes. Fëmijët grupe – grupe shkojnë për të mbledhur një lule pranverore e quajtur kukurek, pasi mbledhin i rrotullojnë vezët në një gjelbërim për të qenë më të fortë. Me të njëjtin qëllim marrin nga 1 degë prej drurit të dushkut dhe thanës. Më pas shkojnë në shtëpi, lulet i vendojnë te trëndafili për t'i marrë para muzgut (akshamit) dhe i vendojnë në çdo cep të shtëpisë, në pemë, në kasollen e bagëtive, në kosharin e misrit, në hambarin e grurit, miellit etj, për të pasur begati gjatë vitit. Në mbrëmje gjyset apo nënat veroren e thurur i'a vendosin në pjesët e cekura të trupit. Të nesërmen domethënë ditën e verës i pari që zgjohet merrë degën e dushkut dhe thanës dhe u bie tre herë në këmbë, në bel dhe kokë anëtarëve të tjerë, duke ju thënë “zgjohuni se do ju munde vera”, “do bëheni përtac” ose “s’do ju ec mbarë”. Ka raste kur goditjet mund të jenë të fuqishme kryesisht për argëtim. Më pas fëmijët grupe – grupe shkojnë nëpër shtëpitë e fshatit apo lagjes. Marrin degë të vogla të emëruar si zogj dhe i vendojnë para shtëpisë dhe brohorasin apo cicërojnë si zogjtë “ciu ciu ciu...”. Njëra nga gratë e familjes del dhe ju jep dhuratë që më e preferuar është të jetë vezë. Për drekë amviset përgatisin kollbirek, një lloj ushqimi në formë rrethore, për të mbledhur anëtarët e familjes. Ushqimi kryesor, i begatshëm ka qenë natën e Kryemotit kur është përgatit qiqri, një lloj buke me karakter ritual, që behet në çdo natë kryemoti apo ditë Arife, domethënë në këtë rast më 13 mars, kurse ditën e verës nuset e reja shkojnë për drekë te shtëpia e prindërve. Dita e Verës është festë që përcjellë në mënyrë imitative kërkesën për një vit sa më të mbarë në çdo aspekt dhe mund të studiohet dhe nga me shumë aspekte.

¹⁵ Ukë Xhemaj, *Etnokultura shqiptare në Podgur*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2003, 230.

Edhe tundësit si një enë cilindrike në të cilën bëhej shndërrimi i kosit në yndyrë dhe dhallë dhe pastaj në gjizë, i kushtohej një rëndësi e veçantë. Ishte praktikë e zakonshme që ai të zbukurohej me disa kukurekë dhe me gjelbërim të ndryshëm, pothuajse në të gjitha trojet shqiptare në Maqedoni. Kështu në fshatin Novo Sellë të Sharrit “Ptini stoliset me kurorë lulësh e gjelbërime. Tundësja var në ptinë një drugë: varet topthi i kandarit dhe një lëmsh i leshtë e i bardhë, me besimin se ptini gjatë vitit do të tundet shpejt e lehtë, si drugëza, e tundnja e tlynit do bëhet e rëndë si topthi i kandarit dhe i bukur si lamshi i leshtë”.¹⁶ Pra, në përgjithësi në vendet ku jetonin shqiptarët në Maqedoni ishte praktikë e përgjithshme që tundësi të zbukurohej me ndonjë kurorë me gjelbërim në mënyra të ndryshme të ndillej begatia e tij, pasi ai ishte simbol i pjellorisë dhe mjet i shndërrimit të kosit në produkte të tjera ushqimore që ishin shumë të rëndësishme për ekzistencën biologjike të çdo bashkësie familjare.

Pothuajse në të gjitha trevat e Maedonisë, ku jetojnë shqiptarët ka qenë praktik e zakonshme që në vigjilje të festës së Ditës së Verës të grumbullohen të rinjtë dhe të rejat kryesisht në bazë të mëhallëve, dhe të dalin në natyrë për të mbledhur lule, apo në rastin e Strugës kukurek, apo vegetacionin e nevojshëm për zbukurimin ritual të shtëpisë, objekteve të tjera ndihmëse, por edhe për ndërtimin e kurorave të ndryshme. Vendtubimi zakonisht është në afërsi të ndonjë shkëmbi me burim të rrjedhshëm me ujë të pijshëm dhe ka ndonjë rrafshinë ku mund të kryhen ceremonitë rituale. Në vendet e lartpërmendura vajzat thurin kurora lulësh, thyejnë degë thanash e shelgu poashtu dhe dushku, mbledhin lulet e stinës dhe me këto stolisin dyert e shtëpive, dyert e ahureve dhe të dhomave. Gjatë këtyre takimeve në malet para se të mbildhet kukureku këndohet kënga: *Kukureku rëj/ rumi sëjt e mëj/ sot e njëmij vjet/ kurxho mos mem gjet.*

¹⁶ Selimi-Osmani, Edibe „Rite e besime popullore në viset e Tetovës dhe të Gostivarit, Asdreni, Shkup, 1996, 126.

Poashtu në këtë ditë karakteristikë për Strugën e sidomos fshatrat Frëngovë, Toska e Belicë e epërme ka qenë ndezja e zjarreve rituale. Ndezja e zjarreve është një karakteristikë e çmueshme e festave kalendarike. Kjo praktikë rituale te shqiptarët e Maqedonisë zbatohet sidomos gjatë festës së Ditës së Verës. Megjithatë edhe gjatë ditës së Shëngjergjit aty-këtu vërehet praktikimi i ritualit të ndezjes së zjarreve. Shefqet Pllana ka të drejtë kur thotë se “ ndër popullsinë shqiptare të Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi, Preshevës etj., festa e Shëngjergjit është festë pranverore më e përhapur dhe në shumë pika përputhet me Ditën e Verës, madje në disa nga këto treva edhe identifikohet duke u shkruar Dita e Verës në Shëngjergj.¹⁷

Kjo është një mënyrë e transmetimit të trashëgimisë shpirtërore nëpërmjet të teknikës më të re, por dhe duke përdorur dhe informacionet dhe burimet vendase, sepse këto festa na tregojnë se ne jemi popull autokton dhe i vjetër në trojet tona shumëshekullore

Në këtë festë kryheshin një varg paraqitjesh rituale me karakter apotropeik. Për ti mbrojtur fëmijët prej mësyshit nënat ose ndonjë i afërm i familjes praktikonin një lloj të qasjes rituale magjike, kështuqë nga njëra anë e mëngores së këmishës së fëmijës i vendosnin një *nishan* apo *nishandër* me një gjilpërë në formë kapse e quajtur *grafic*, ku janë të shënuara tre kokrra të elbebijave. Ky zakon i kushtohej të porsalindurve, jo më të vegjël se njëvjeçar. Për fëmijët më të mëdhenj, në moshën nga një deri në pesë vjet nënat praktikojnë një lloj tjetër riti, por me të njëjtën qëllim. Ato gjatë festës së Ditës së Verës, fëmijëve të tyre, në mëngët e këmishës i përshkronin një varg me elbebija, duke filluar nga shpina deri në shuplakë, dhe atë në dorën e djathtë nga ana e parme, kurse në të majtin nga pjesa e prapme. Ky zakon është bazuar në besimin se ana e majtë është “*e keqe*” përkatësisht se “*nga ajo vijnë qëndrimet e*

¹⁷ Shefqet Pllana, Kwngwt e motmotit ndwr shqiptarw, Gjurmime Albanologjike 2/ 1965, Prishtinw, 1965, f.228-229.

këqija, gjë që shkakton që dhe punët të shkojnë mbrapsht”. Këto nishane fëmijët i mbanin prej ditës së Verës, dntë nga 14 marsi e deri në Shën Gjergj, përkatësisht më 6 maj. Fëmijët e tjerë, prej moshës pesë vjeçare, e deri në pubertet, në këtë periudhë iniciuese të kalendarit të ditëve rituale, sipas besimeve është e mbushur me magji dhe fuqi demonike, mbanin në dorën e djathtë veroren apo *sinjelken*, thurje nga penjtë e kuq e të bardhë të pambukut, mbi të cilën vendoheshin edhe moneta metalike të vjetra e të perfonuara. Në të kaluarën në këtë periudhë të vitit fëmijët veshnin xhamadan e thurur nga materiali i leshtë, këmishë të pambuktë dhe çorape të leshta, të gjitha me ngjyrë të kuqe në të bardhë në funksion të mbrojtjes nga magjitë dhe mësyshit.

Anëtarët e tjerë të familjes, veroren e vendonin në bizilikon e dorës, me besimin se në këtë mënyrë do të mbrohen nga çdo e keqe. Poashtu, të rriturit, veroren e vendonin dhe në gishtin e madh të këmbës së djathtë, me qëllim që të mos pengohen dhe rrëzohen gjatë tërë vitit. Fëmijët, poashtu veroret i mbajnë deri në momentin kur do të shohin ndonjë zog shtegtar, dhe menjëherë ti lënë në ndonjë degë druri.

Ky zakon e vërteton simbolikën, apo karakterin apotropeik të verores, por në përgjithësi edhe të ngjyrës së bardhë dhe të kuqe, si simbole apotropeike të shtresëzuar në kulturën popullore të shqiptarëve, të maqedonasve dhe popujve tjerë të Ballkanit, e cila flet për karakterin arkaik të këtij zakoni.

Në kohën e Ditës së Verës, Shën Gjergjit dhe Shën Mitrit (8 nëntor), nusët dhe gratë e reja e vishnin veshjen e vetë festive, e plotësuar me elemente të tjera dekorative me karakter ritual. Kështu, në vend të brezit nusëror vendonin tjetër të dekoruar me motive të kuqe në formë të vijave horizontale, në qoshet e së cilave formohen një degëzim i pasur me resë të kuqe.

Për këto festa në veçanti ato u jepnin një rëndësi edhe rregullimit të flokëve, më së shumti të thurura në dy gërsheta *apo qetka*, të cilën në mënyrë plotësuese e formonin me shtesa të gjata të leshta, deri në thembra, detyrimisht me ngjyrë të kuqe. Nëpër skaje këto dy gërsheta janë lidhur dhe dekoruar në një të përbashkët prej reskave të bera prej ngjyre të kuqe, të cilët në kohë më të re janë zëvendësuar me penj të argjendta dhe gajtane. Ky rregullim i flokëve, tek popullsia e Strugës është e njohur si *kocak* dhe është e lidhur me kultin e pjellorisë dhe fuqisë jetësore. Për këto arsye atë mund ta mbanin vetëm gratë e martuara si simbol i fuqisë së tyre të fertilitetit dhe statusit të tyre social. Mbi kocak ato mbanin dhe shami të bardhë apo shami nusesh e punuar prej materialit të pambuktë e dekoruar me motive gjeometrike më së shpeshti nga trekëndësha.



Kocak nusesh si simbol i fertilitetit , (Veshje nusesh të reja, Koroshishtë, Strugë)

Nga e gjitha kjo që thamë mund të konkludojmë se shqiptarët kanë qenë shumë të lidhur me tokën e të parëve, të cilës në mënyra të ndryshme i bënin kulte, qoftë në mënyrë direkte apo indirekte dhe nëpërmjet të këtyre kulteve kërkonin më të mirën për jetën e tyre. Kjo festë ka dhe shumë gjëra për tu studiuar, në aspekte të ndryshme, duke u nisur nga disa rite që në vetvete kanë një parapsikologji të thellë popullore.

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

DITA E VERËS NË STRUGË

SCUPI – 15

Shtypi: Fokus Print – Shkup

CIP – Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

398.332.2(=18:497.7)

DITA e verës në Strugë : (tribunë shkencore – 14.03.2016). 15. –

Shkup : Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të

shqiptarëve, 2016. – 94 стр. : фотограф. ; 21 см. – (Biblioteka

Scupi)

Фусноти кон текстот

ISBN 978–608–4653–43–1

а) Албанци во Македонија – Народни обичаи – Летни празници

COBISS.MK–ID 101999114